



STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

Tema:

**Dimensioni politik dhe ekonomik i procesit të decentralizimit në Republikën e
Maqedonisë**

**(The political and economic dimension of the decentralization process in the
Republic of Macedonia)**

KANDIDATI:

Arlind Qamili

MENTORI:

Prof. Dr. Memet Memeti

TETOVË, 2019

Përmbajtja

Falënderim	7
KAPITULLI I - DECENTRALIZIMI (KORNIZA TEORIKE)	13
1. Hyrje.....	13
2. Koncepti teorik – Decentralizmi.....	13
2.1. Dekoncentrimi.....	18
2.2. Delegimi	18
2.3. Devolucioni	18
3. Dimensioni politik i procesit të Decentralizimit.....	19
4. Komunitet si institucione demokratike	22
5. Konkluzion.....	27
KAPITULLI II - DECENTRALIZIMI POLITIK.....	28
1. Hyrje.....	28
2. Marrëveshja Kornizë e Ohrit.....	28
3. MKO si model i zgjidhjes së marrëdhënieve ndëretnike	31
4. Parimet themelore.....	32
5. Ndërprerja e armiqësive	32
6. Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar	33
7. Mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë.....	34
8. Procedurat e posaçme kuvendore	34
9. Arsimiti dhe përdorimi i gjuhëve.....	35
10. Shprehja e identitetit	36
11. Implementimi	37
12. Konkluzion.....	39
KAPITULLI III - DECENTRALIZIMI EKONOMIK.....	40
1. Hyrje.....	40
2. Decentralizimi ekonomik	40
3. Decentralizimi fiskal në R. M.....	44
3.1. Të ardhura nga tatimi personal.....	49
3.2. Të ardhura nga tatimi i vlerës së shtuar	49

3.3.	Dotacione të dedikuara.....	50
3.4.	Blok dotacione	51
4.	Dotacione nga buxhetet e fondeve dhe huazimeve	51
4.1.	Dotacione kapitale	51
4.2.	Huazimet e komunave	51
4.3.	Të ardhura nga donacione	52
5.	Decentralizimi dhe zhvillimi i barabartë rajonal	53
6.	Planifikimi i zhvillimit rajonal (Rajonet e planit)	58
7.	Financimi i zhvillimit rajonal (Burimet e financimit të zhvillimit rajonal)	59
8.	Shpërndarja e mjeteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.....	59
9.	Ndarja e mjeteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.....	59
10.	Perspektivat e decentralizmit fiskal	64
11.	Ku është Republika e Maqedonisë në këtë proces?	66
KAPITULLI IV – STUDIMI EMPIRIK (PËRSHKRIMI I TË DHËNAVE NGA TË ANKETUARIT).....		67
1.	Hyrje.....	67
2.	Studimi empirik-Mendimi i qytetarëve (Përshkrimi i të dhënave)	67
3.	Konkluzion.....	89
4.	Përfundime dhe rekomandime.....	89
Bibliografia		94

Lista e tabelave

Tabela 1: A ndikoi procesi i decentralizimit pozitivisht në marrëdhëniet politike dhe etnike në R.M.?	69
Tabela 2: A keni dëgjuar për komisionin për marrëdhënie në mes komuniteteve në RM?	71
Tabela 3: A mendoni se ka ndryshim në dimensionin politik të decentralizimit në R.M.?	72
Tabela 4: Sa jeni të kënaqur prej zbatimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit pas 17 viteve?	73
Tabela 5: A mendoni se të hyrat personale mjaftojnë për të realizuar kompetencat dhe shërbimet publike lokale?.....	75
Tabela 6: Sa ndikoi procesi i decentralizimit fiskal në R.M.?	77
Tabela 7: A e përmirësoi procesi i decentralizimit mirëqenien ekonomike të qytetarëve?	78
Tabela 8: A mendoni se decentralizimi fiskal krijoi perspektiva të reja në R.M.?	80
Tabela 9: A mendoni se pushteti lokal ballafaqohet me mungesë të mjeteve nga pushteti qendrorë?	82
Tabela 10: Në komunën time investohet rregullisht në mirëmbajtjen e rrugëve lokale	83
Tabela 11: Në komunën time investohet rregullisht në objektet arsimore	84
Tabela 12: Në komunën time investohet në objekte në sferën e mbrojtjes sociale.....	86
Tabela 13: Në komunën time është krijuar ambient ekonomik për investime.....	87
Tabela 14: Në komunën time ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokal	88

Tabela e figurave

Figura 1: Struktura gjinore e të anketuarve.....	68
Figura 2: Struktura sipas përkatësisë etnike	69
Figura 3: A keni dëgjuar për komisionin për marrëdhënie në mes komuniteteve në RM?	70
Figura 4: A mendoni se ka ndryshim në dimensionin politik të decentralizimit në R.M.?	71
Figura 5: Sa jeni të kënaqur prej zbatimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit pas 17 viteve?	73
Figura 6: A mendoni se të hyrat personale mjaftojnë për të realizuar kompetencat dhe shërbimet publike lokale?.....	75
Figura 7: Sa ndikoi procesi i decentralizimit fiskal në R.M.?.....	76
Figura 8: A e përmirësoi procesi i decentralizimit mirëqenien ekonomike të qytetarëve?	78
Figura 9: A mendoni se decentralizimi fiskal krijoi perspektiva të reja në R.M.?.....	80
Figura 10: A mendoni se pushteti lokal ballafaqohet me mungesë të mjeteve nga pushteti qendrorë?	81
Figura 11: Në komunën time investohet rregullisht në mirëmbajtjen e rrugëve lokale.....	83
Figura 12: Në komunën time investohet rregullisht në objektet arsimore.....	84
Figura 13: Në komunën time investohet në objekte në sferën e mbrojtjes sociale	85
Figura 14: Në komunën time është krijuar ambient ekonomik për investime	86
Figura 15: Në komunën time ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokal	88

Falënderim

Përfundimi i këtij studimi nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen e kolegëve, bashkëpunëtorëve dhe dashamirëve të shkencës që më dhanë sugjerimet e nevojshme dhe shumë kuptimplote.

Falënderimet i takojnë edhe familjes sime që më dha përkrahjen morale dhe materiale gjatë gjithë procesit të ngritjes sime akademike.

Një falënderim i veçantë i takon edhe mentorit tim Prof. Dr. Memet Memeti i cili nuk hezitoi për asnjë çast duke më ndihmuar me shumë sinqeritet njerëzor dhe korrektësi profesionale.

U jam mirënjohës të gjithëve që në çfarëdo mënyre kontribuan për realizimin me sukses të këtij cikli studimesh.

Abstrakt

Decentralizimi si koncept filloi të përhapet në vendet që ishin në tranzicion, atje ku pushteti centralist e kishte të vështirë ambientimin me situatën e re pluraliste.

Me decentralizim nënkuptohet shpërndarja e autoritetit nga niveli qendror në nivel lokal.

Decentralizimi si faktor kyç luan një rol të rëndësishëm, jo vetëm në jetën politike dhe ekonomike të funksionimit të një shteti, por edhe në të gjitha nivelet jetësore (kulturore, arsimore, sportive, fetare, sociale etj.). Republika e Maqedonisë me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit theksoi se në zhvillimin e pushtetit të decentralizuar do të miratohet ligj i reviduar i pushtetit lokal me të cilin do të forcohen autorizimet e përfaqësuesve të zgjedhur vendor dhe dukshëm do të rriten kompetencat e tyre në pajtim me kushtetutën; se do të miratohet ligji për financimin e pushtetit vendor me qëllim që të sigurohet sistemi përkatës i financimit për t'u mundësuar autoriteteve vendore t'i plotësojnë kompetencat e tyre.

Decentralizimi u mundëson komunave që ta kenë më lehtë procesin e plotësimit të kërkesave të shumta dhe jetike që parashtrohen nga qytetarët.

Ky studim nxjerr në pah arritjet e deritanishme, ndryshimet e bëra përgjatë kohës, ndikimin e këtij procesi në përmirësimin e gjendjes politike dhe ekonomike si dhe domosdoshmërinë e rregullimit të mëtejshëm të ligjeve, rregullave, procedurave dhe kushteve për mirëqenien e qytetarëve.

Në pjesën e studimit empirik që fokusohet kryesisht në zonën e Pollogut të Poshtëm ku janë përfshirë gjithsej 200 qytetarë, konstatohet se decentralizimi ende mbetet një faktor i rëndësishëm i parealizuar dhe akoma nuk gjen zbatim në jetën reale.

Sa i përket nivelit lokal, ai përballlet me vështirësi në përmbushjen e kërkesave për zhvillim kapital nga ana e qytetarëve si dhe me mungesë të plotësimit të nevojave të qytetarëve.

Fjalët kyçe: decentralizimi, komuna, pushteti, tatimi, buxheti, MKO (Marrëveshja Kornizë e Ohrit), vetqeverisja lokale, kredi bankare, fondet, investimet.

Апстракт

Децентрализацијата како концепт почна да се шири во земјите во транзиција, каде што централната власт се уште не беше спремна да се справи со новата плуралистичка ситуација.

Децентрализацијата подразбира распределба на власта од централно ниво во локално ниво.

Децентрализацијата како клучен фактор игра важна улога, не само во политичкиот и економскиот живот на една држава, туку и на сите нивоа на животот (културни, образовни, спортски, верски, социјални итн.). Република Македонија со Охридскиот рамковен договор нагласи: дека во развојот на децентрализираната власт ќе биде усвоен ревидиран закон за локална самоуправа, со кој ќе се зајакнат овластувањата на избраните локални претставници и значително ќе се зголемат нивните надлежности во согласност со уставот; дека законот за финансирање на локалната самоуправа ќе биде усвоен со цел да се обезбеди релевантниот систем на финансирање кој ќе им овозможи на локалните власти да ги исполнат своите надлежности.

Децентрализацијата им овозможува на општините полесно да го пополнат процесот на исполнување на многуте и витални барања што граѓаните ги поднесуваат.

Оваа студија ги истакнува досегашните достигнувања, промените направени со текот на времето, влијанието на овој процес врз подобрувањето на политичката и економската ситуација и потребата од понатамошно регулирање на законите, правилата, процедурите и условите за благосостојбата на граѓаните.

Во емпириската студија која главно се фокусира на областа Долни Полог, каде што беа вклучени 200 граѓани, се констатира дека децентрализацијата и натаму останува важен нереализиран фактор и сè уште не е применет во реалниот живот.

Што се однесува до локалната власт, таа се соочува со тешкотии во исполнувањето на барањата за капитален развој од страна на граѓаните, како и поради недостатокот на задоволување на потребите на граѓаните.

Клучни зборови: децентрализација, општина, власт, данок, буџет, ОРД (Охридски рамковен договор), локална самоуправа, банкарски влогови, фондови, инвестиции.

Abstract

Decentralization as a concept began to spread to countries in transition, where the central government wasn't yet ready to cope with the new pluralistic situation.

Decentralization involves the allocation of power from the central level to the local level.

Decentralization as a key factor plays an important role not only in the political and economic life of a state, but also at all levels of life (cultural, educational, sports, religious, social, etc.). The Republic of Macedonia with the Ohrid Framework Agreement emphasized that in the development of the decentralized government, a revised Law on Local Self-Government will be adopted, which will strengthen the powers of the elected local representatives and significantly increase their competencies in accordance with the Constitution; that the law on financing of local self-government will be adopted in order to provide the relevant financing system that will enable local authorities to fulfill their responsibilities.

Decentralization allows municipalities to more easily fill the process of accomplishment the many vital needs that citizens submit.

This study highlights the achievements so far, the changes made over time, the impact of this process on improving the political and economic situation and the need for further regulation of the laws, rules, procedures and conditions for the well-being of citizens.

In an empirical study focusing mainly on the Lower Polog area, where 200 citizens were involved, it was concluded that decentralization remains an important unrealized factor and has not yet been applied in real life.

Regarding the local government, it faces difficulties in meeting the requirements for capital development by the citizens, as well as due to the lack of satisfaction of the needs of the citizens.

Key words: decentralization, municipality, government, tax, budget, OFA (Ohrid Framework Agreement), local self-government, bank deposits, funds, investments.

KAPITULLI I - DECENTRALIZIMI (KORNIZA TEORIKE)

1. Hyrje

Në këtë kapitull trajtohet decentralizimi kryesisht në kuptimin e tij të përgjithshëm teorik, pastaj zhvillimi lokal i tij, dimensionin politik si dhe mundësitë që ofron ky proces politik dhe ekonomik. Gjithashtu trajtohen tema që kanë të bëjnë në veçanti me pushtetin lokal, me komunat si institucione demokratike, me funksionin e tyre, me vetëqeverisjen lokale si dhe rolin e tyre gjatë bartjes së aktiviteteve që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me qytetarët.

2. Koncepti teorik – Decentralizmi

Nga perspektiva e qytetarëve të zakonshëm, nivelet qendrore shpesh janë shumë larg plotësimit të nevojave dhe kërkesave me të cilat përballet qytetari për çdo ditë. Kohët e fundit, decentralizimi është një nga temat që më së shumti debatohet dhe diskutohet në nivel global si dhe një proces që ka ngjallur interesin e ekonomistëve, analistëve, juristëve e shumë studiuesve të tjerë.

Në shumë vende me sisteme të centralizuara, ndjekja e kriterëve të qeverisjes së mirë ka lënë pas dore nivelin e qeverisjes lokale. Pavarësisht reformave të shumta dhe mjeteve të shpenzuara nga nivelet qendrore, ato përsëri kanë dështuar në ofrimin e shërbimeve cilësore lokale dhe të qëndrueshme, me qëllim të përmirësimit të standardit jetësor të qytetarëve, pasi që ato gjenden larg nevojave dhe problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët për çdo ditë.

Nga ana tjetër, nivelet lokale janë ato që pikërisht ndodhen më afër qytetarëve dhe që i njohin nevojat dhe problemet me të cilat ballafaqohen familjet dhe anëtarët e tyre për çdo ditë. (Kälin, 2002)

Jepen shumë përkufizime rreth decentralizimit, por një përshkrim i përgjithshëm është se ai

paraqet transferimin e autoritetit dhe përgjegjësisë së funksioneve publike nga pushteti qendror në nivel lokal. Në fakt, ai ka të bëjë me të drejtën e qytetarëve të një vendi për të marrë pjesë në menaxhimin dhe administrimin e punëve publike. Kjo e drejtë ushtrohet direkt dhe në mënyrë më efikase në nivelin vendor se sa në atë qendror. Reforma të këtilla për decentralizimin janë ndërmarrë si në vendet e zhvilluara ashtu edhe te ato në zhvillim.

Ndërsa tek vendet në tranzicion, decentralizimi shfaqet si rezultat i drejtpërdrejtë i tranzicionit nga sistemi ekonomik socialist drejt ekonomisë së tregut ku ndikim kanë patur faktorët që përfshijnë gjendjen e përgjithshme ekonomike, rendin ligjor, reformat ekonomike, politike, kulturore etj. Sipas Kälin (2002), jepen katër arsye kryesore për forcimin e qeverisjes lokale, të cilët janë:

1. Administrimi eficient dhe përgjegjës - dështimet e nivelit qendror në ofrimin e shërbimeve shpeshherë vijnë jo si mungesë e parave, por për shkak të një përdorimi eficient të burimeve të disponueshme. Kjo për faktin se ekzistojnë disa distanca si p.sh.: distanca gjeografike e cila sjell te niveli qendror mungesën e informacionit për nevojat dhe problemet lokale; distanca psikologjike ndërmjet zyrtarëve të nivelit qendror dhe popullit që ato udhëheqin. Shumë aktivitete të nivelit qendror në nivel lokal nuk zhvillohen jo për shkak të kërkesës së qytetarëve lokalë, por për shkak të ideologjisë së zhvillimit të interesave të nivelit qendror.
2. Më shumë zhvillim të lokalitetit - zhvillimi lokal është i mundshëm edhe pa decentralizim, por në shumë vende motivi kryesor për decentralizim është perspektiva për zhvillim lokal, sepse qytetarët inkurajohen për hartimin dhe implementimin e suksesshëm të projekteve të tyre lokale.
3. Demokraci dhe mbrojtje e lirisë - e drejta për të zgjedhur liderët e nivelit qendror është një pjesë e demokracisë, por demokracia përfshin edhe mundësinë për të influencuar në vendime që ndikojnë direkt në jetën e një personi. Qeverisja lokale është e aftë për të ofruar këto aspekte të demokracisë që niveli qendror nuk mund t'i ofrojë.
4. Zhvillimi lokal ndihmon në reduktimin e kostove - nëse banorët vendas mendojnë se paraja është e tyre, atëherë ato kanë më shumë gjasa të jenë vigjilent mbi shpenzimet

dhe të përdorin paratë në mënyrë më efikase. Përveç kësaj, ka më shumë mundësi për kontribute publike për të shtuar një projekt lokal.

Nocioni decentralizim (de dhe qendra, lat - nga qendra) është antipod i centralizimit - që është parim, koncept i organizatës që nënkupton rritjen e kompetencave të organeve qeveritare periferike dhe institucioneve jo-qeveritare në raport me administrimin e qeverisë qendrore, me ç'rast ato organe dhe institucione, në një farë mase, mbeten të nënshtuara në raport me instancat më të larta administrative. Me fjalë të tjera, decentralizimi duhet të kuptohet si transferim i funksioneve të pushtetit, realizimi i të cilit mbetet nën kontrollin johierarkik të transferuesit. Këtu, fjala është për të ashtuquajturin decentralizim i mirëfilltë, respektivisht transferimi i pushtetit në subjektet jo-qeveritare të cilët janë nën kontrollin jo hierarkik të një niveli më të lartë qeverisës. Nëse me subjektet e njëjta transferohet edhe pushteti legjislativ, flitet për të ashtuquajturin "devolucion, si një formë e decentralizimit gjegjësisht për autonominë, në rast të transferimit të autorizimit për nxjerrjen e ligjeve në kuptimin material, të cilët vlejnë vetëm në territorin e ndonjë zone autonome. Nga ana tjetër, nëse bëhet fjalë për transferimin e funksioneve të pushtetit në organet dhe organizatat shtetërore nën kontrollin hierarkik, atëherë fjala është për të ashtuquajturin decentralizim administrativ i paligjshëm.

Në teorinë juridike, ekzistojnë më tepër mënyra të paraqitjes së decentralizimit si: territorial dhe jo-territorial, pastaj, varësisht nga cili lloj i qeverisjes transferohet në forma decentralizuese: normativ, administrativ dhe gjyqësor.

Sikur që nuk ka shtet të centralizuar, në kuptimin absolut, njëjtë, nuk ka as shtet absolutisht të decentralizuar (eksperiment i pasuksesshëm me konceptin e socializmit vetëqeverisës është dëshmia më e mirë). Prandaj, dilema e vetme thelbësore nuk qëndron në faktin nëse shteti është apo jo i decentralizuar, por në çështjen se deri në çfarë mase ai është apo jo i decentralizuar.

Marrëdhënia e decentralizimit dhe centralizimit është, në fakt, marrëdhënia ndërmjet zonës së vlefshmërisë së normave juridike si dhe autoriteteve që të njëjtat norma, i miratojnë dhe i zbatojnë. Rendi i decentralizuar ligjor ekziston si një sistem i normave në fusha të ndryshme si

ato: territoriale, të vlefshmërisë, juridik (i vlefshëm vetëm në një zonë të caktuar). Ai themelohet nga organet e zgjedhura vetëm nga anëtarët e të njëjtës zonë.

Si përparësi themelore e një modeli të decentralizuar të vendimmarrjes dhe menaxhimit merret fakti se decentralizimi është një faktor i rëndësishëm i demokratizimit të rendit ligjor të çdo shteti. Në këtë sistem, vendimmarrësit janë më afër lëndës (kjo, në mënyrë të veçantë, vlen për decentralizimin territorial), kurse për organizimin më të lehtë të aparateve administrative nën-shtetërore, thjesht dhe lehtë drejtohen procedurat e vendim-marrjes. Po ashtu, komunikimi mes instancave nga nivele të ndryshme është më efektive, kurse transparencë më e madhe në realizimin e punëve kontribuon në largimin më të lehtë dhe më efikas të gabimeve të ballafaquara.

Parakushti për suksesin e konceptit të decentralizimit është mbi të gjitha nivel i caktuar i zhvillimit ekonomik të shtetit. Në fakt, në vendet me fuqi më të vogël ekonomike, decentralizimi në mënyrë të pashmangshme çon drejt diferencimit të vazhdueshëm të organizimit shtetëror, apo copëtimit të tij për shkak të krijimit të rrjetit të organeve dhe organizatave jo-shtetërore me një aparat të madh burokratik, që nuk është e lehtë për t'u financuar në mënyrë adekuate nga të ardhurat publike lokale. Gjithashtu me rëndësi të madhe është edhe niveli i vetëdijes kulturore, respektivisht vetëdijes kolektive, sepse, në qoftë se këto gjëra mungojnë në kuadër të popullsisë së një territori të caktuar, në qoftë se ata nuk i shlyejnë rregullisht detyrimet e tyre fiskale, vjen në pikëpyetje edhe vetë funksionimi apo puna e suksesshme dhe efektive e vetëqeverisjes së decentralizuar.

Procesi i decentralizimit, i menaxhimit të subjekteve në nivel ekonomik - juridik zbatohet për të përfshirë një rreth sa më të gjerë të stafit profesional në procesin e vendimmarrjes dhe ndarjen e përgjegjësisë për realizimin e suksesshëm të politikës së planifikuar afariste. Sipas rregullit, ky proces kryhet përmes: transferimit të autorizimeve - përgjegjësi nga menaxherët e nivelit më të lartë në nivelin më të ulët si dhe / ose duke e shpërndarë biznesin e kompanisë në më shumë

ose më pak njësi të pavarura biznesi. Zgjedhja e modelit varet nga fuqia ekonomike e një subjekti biznesi - zakonisht kombinohen të dyjat.

Decentralizimi është procesi i shpërndarjes ose i rishpërndarjes së funksioneve, fuqive, njerëzve apo gjërave larg nga një vendndodhje ose autoritet qendror. Konceptet e decentralizimit janë aplikuar për dinamikën e grupeve dhe shkencën e menaxhimit në biznesin privat, për shkencat politike, ligjin dhe administratën publike, ekonominë dhe teknologjinë. Kuptimi i decentralizimit mund të ndryshojë pjesërisht për shkak të mënyrave të ndryshme të zbatimit.

Decentralizimi është transferimi i autoritetit dhe përgjegjësisë për funksione publike nga pushteti qendror në organizata qeveritare vartëse apo pothuajse të pavarura ose në sektorin privat. Ai mbulon një hapësirë të gjerë konceptesh¹. Çdo lloj decentralizimi - politik, administrativ, fiskal apo i tregut - ka karakteristika, rrjedhime politike dhe kushte të ndryshme për sukses. Të gjithë këta faktorë duhet të konsiderohen me kujdes përpara se të vendoset nëse projekti apo programi duhet të mbështesë riorganizimin e sistemeve financiare, administrative dhe shpërndarjen e shërbimeve. Diferencimi i llojeve të ndryshme të decentralizimit është i rëndësishëm pasi hedh dritë në dimensionet e shumta të tij dhe nevojën për koordinim, por nga ana tjetër këto koncepte mbivendosin njëra tjetrën. Decentralizimi politik, administrativ, fiskal dhe i tregut mund të shfaqen në forma dhe kombinime të ndryshme në vende të ndryshme, brenda vendit dhe madje edhe brenda sektorëve. Përkufizimet e sakta janë më pak të rëndësishme sesa përcaktimi i një modeli të kuptueshëm. (Ahmad, Juanid; Blair, Harry; Esmail, Talib; Ford, James; Hoffman, Bert; Kerr, Graham; King, Elizabeth; Lutz, Ernst; Mclean, Keith; Rondinelli, Dennis; Sewell, David; Shah, Anwar; DeTomaso, Giulio; Weist, Dana, 1999).

Mënyrat e shumta të cilat sot shfrytëzohen për delegimin e përgjegjësisë në vendimmarrje mund të kufizohen në tri forma themelore të decentralizimit: dekoncentrimi, delegimi dhe devolucioni.

¹ Decentralizimi - Shënime përmbledhëse, 1999, Instituti i Bankës Botërore, Washington D.C., fq. 2.

2.1. Dekoncentrimi

Dekoncentrimin e quajmë ndryshe edhe si decentralizim administrativ. Ai është forma më e ulët e decentralizimit sepse është kufizuar në shpërndarjen e përgjegjësiave në mes niveleve të ndryshme të administratës publike, në një kohë kur fuqia për vendimmarrje mbetet në duart e administratës shtetërore. Për shkak se njësitë dekoncentruese janë më afër zonave të punës së tyre, ato veprojnë duke e njohur shumë mirë situatën, në këtë mënyrë mund të komunikojnë më mirë me palët që janë të përfshira në punën e tyre dhe janë në pozicion më të mirë për zbatimin e vendimeve administrative.

2.2. Delegimi

Delegimi është forma më gjithëpërfshirëse e decentralizimit sepse përgjegjësia për kryerjen e detyrave specifike i delegohet organizatave gjysëmautonome (si shërbime të veçanta, ndërmarrje publike etj.) të cilët administrata shtetërore nuk i kontrollon në tërësi, por që asaj i konvenojnë. Duke i dhënë nivele të veçanta të përgjegjësiave gjatë vendimmarrjes, këto organizata në vendimmarrje kanë një shkallë të caktuar të lirisë, prandaj shpesh munden që shfrytëzuesve direkt t'ua paguajnë shërbimet që u jepen. Me fjalë të tjera delegimi është transferim i autorizimit për kryerjen e funksioneve publike specifike.²

2.3. Devolucioni

Devolucioni është sinonim i decentralizimit fiskal, me të cilin delegohen kompetenca të caktuara mbi tatimin dhe konsumin publik në trupat lokale dhe krahinore në pushtet, respektivisht kur pushteti publik krahinor dhe lokal kanë funksione të ndara qartë dhe autonomi të rëndësishme të kontabilitetit, pra pushtet për mbledhjen e taksave dhe tatimeve për financimin e kostove.

² Marrë nga Podrobnije vidjeti o oblicima decentralizacije u: R. M. Bird i F. Vaillancourt, Fiscal Decentralisation in Developing Countries, Cambridge University Press, New York and London, 1999., fq. 3.

Duke sjellë kështu vendime mbi konsumin,³ pranimi i parimeve të caktuara ekonomike bëhen bazë për decentralizimin fiskal të suksesshëm.

Decentralizimi në Evropën Jug-Lindore është akoma një aktivitet në zhvillim. Të ardhurat apo shpenzimet e qeverive vendore nuk arrijnë mesataren sipas BE-se, as si përqindje e PBB-së dhe as si përqindje ndaj totalit të të ardhurave publike - në asnjë nga vendet e rajonit. Gjatë pesë viteve të fundit ka pasur pak ndryshime të rëndësishme në financat dhe përgjegjësitë ndaj shërbimeve të qeverive vendore në të gjithë Evropën Jug-Lindore. Kjo presupozon se politikat e hartuara për të transferuar pushtetin dhe paranë drejt qeverive vendore që filloi në fund të viteve 1990 janë venitur, dhe në disa vende kanë ngecur në vend. Pjesë e shpjegimit për këtë humbje të momentit mund të jetë edhe elementi strukturor. Nga njëra anë, dendësia e ulët e popullsisë në shumicën e qeverive vendore në Evropën Jug-Lindore e bën shpërndarjen e shërbimeve publike për në vendbanimet e ndryshme të vështirë dhe të kushtueshme. Nga ana tjetër, përqendrimi disproporcional i njerëzve, pasurisë dhe pushtetit në kryeqytetet e rajonit ka penguar zhvillimin e sistemeve efektive të ekualizimit. Kjo e ka bërë edhe më të vështirë përcaktimin e burimeve të qëndrueshme të qeverive vendore nga të ardhurat e veta. Në më të shumtën e vendeve të rajonit, grantet e pakushtëzuara luajnë një rol relativisht modest në financimin e qeverive vendore. Kjo ka rëndësi sepse nëpërmjet granteve të pakushtëzuara shumë vende rezultojnë me qeveri vendore më të varfra përse i përket të ardhurave shtesë. Përdorimi i pakët i granteve të pakushtëzuara ngre pyetje të rëndësishme rreth barazisë në sistemet financiare ndërqeveritare në rajon. (Anthony, et al., 2012).

3. Dimensioni politik i procesit të Decentralizimit

Në përgjithësi ekzistojnë tre forma të procesit të decentralizimit edhe atë: politik, administrativ dhe fiskal.

³ S. Drezgić, Lokalni javni sektor u sustavu javnog financiranja Republike Hrvatske, Zbornik radova znanstvenog skupa Hrvatska., fq. 318.

Decentralizimi politik ka të bëjë me sforcimin më të madh të qytetarëve për të vendosur në nivelin lokal si dhe përfaqësuesve të tyre.

Decentralizimi politik synon t'u japë qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur të tyre më shumë pushtet në procesin e marrjes së vendimeve publike. Ky lloj decentralizimi shpesh është i shoqëruar me politika pluraliste dhe qeveri përfaqësuese, por ai mund të mbështesë gjithashtu demokratizimin duke u dhënë qytetarëve ose përfaqësuesve të tyre më tepër influenca në formulimin dhe zbatimin e politikave. Mbrojtësit e decentralizimit politik pretendojnë se vendimet e bëra me një pjesëmarrje më të gjerë do të jenë më të mirë informuara dhe më të fokusuara në interesat e shoqërisë, sesa ato të bëra nga autoritetet politike kombëtare. Ky koncept nënkupton se zgjedhja e përfaqësuesve nga juridiksionet lokale elektorale u jep mundësi qytetarëve që t'i njohin më mirë përfaqësuesit e tyre politikë dhe u jep gjithashtu mundësi zyrtarëve të zgjedhur t'i njohin më mirë nevojat dhe dëshirat e zgjedhësve të tyre. Decentralizimi demokratik shpesh kërkon reforma kushtetuese, krijimin e partive politike pluraliste, forcimin e legjislacionit, krijimin e njësive lokale politike dhe inkurajimin e grupeve efektive publike. (Ahmad & Blair, 1999).

Decentralizimi, në aspektin e tij politik e demokratik, ka dy komponente kryesore: pjesëmarrjen dhe përgjegjësinë. Pjesëmarrja ka të bëjë kryesisht me rritjen e rolit të qytetarëve në zgjedhjen e drejtuesve të tyre lokalë dhe në atë që këta drejtues duhet të bëjnë - me fjalë të tjera duke dhënë impute në qeverisjen lokale. Përgjegjësia është ana tjetër e procesit, ajo është shkalla ndaj së cilës pushtetet lokale duhet të shpjegojnë ose justifikojnë çfarë ata kanë bërë ose jo. Informacioni i përmirësuar mbi nevojat lokale dhe preferencat është një nga avantazhet teorike të decentralizimit, por nuk ka garanci që drejtuesit aktualisht do të veprojnë mbi këto preferenca përderisa ata të ndiejnë një lloj përgjegjësie ndaj qytetarëve. Zgjedhjet lokale janë më të zakonshmet dhe forma më e fuqishme e përgjegjësisë, por mekanizmat e tjerë, të tilla si këshillat e qytetarëve mund të kenë influenca të kufizuara. Përgjegjësia mund të shikohet si vlera e pjesëmarrjes. Nëse pjesëmarrja në rritje ka vlerë, atëherë njerëzit mund të përdorin rrugët e

pjesëmarrjes për ta bërë pushtetin lokal të përgjegjshëm për veprimet e tij. (Litvack & Seddon, 1998)

Dy konceptet: centralizimi dhe decentralizimi, kanë anët pozitive dhe negative, avantazhi i njërit thjesht është disavantazh i tjetrit. Decentralizimi na krijon një perceptim të përgjithshëm, të qartë dhe të saktë për qëllimin, detyrat dhe interesin e gjithë shtetit, respektivisht organizatës që drejton. Si avantazh i decentralizimit gjatë marrjes së vendimeve theksohen:

Redukton barrën e drejtuesve më të lartë - decentralizimi ju lehtëson drejtuesve të lartë barrën e kryerjes së funksioneve të ndryshme. Centralizimi i autoritetit vë të gjithë përgjegjësinë mbi supet e një ekzekutivi dhe grupit të tij në mënyrë të menjëhershme. Decentralizimi shkurton kohën në dispozicion të drejtuesve më të lartë të cilët duhet të përqendrohen në funksione të tjera të rëndësishme menaxheriale. Pra, e vetmja mënyrë për të pakësuar barrën e tyre është decentralizimi i pushtetit vendimmarrës dhe delegimi i kompetencave vartësve.

Rrit moralin dhe motivimin - morali i të punësuarve rritet për shkak të delegimit të autoritetit. Decentralizimi ndihmon për të rritur moralin e punonjësve, sepse ai përfshin delegimin. Punonjësit janë të motivuar për të punuar. Louis A. Allen thekson: "Decentralizimi stimulon formimin e grupeve të vogla kohezive. Drejtuesit lokalë kanë një shkallë të lartë të pushtetit dhe autonomisë vendore, ata kanë tendencë që të bashkojnë njerëzit e tyre në grupe të integruara ngushtë". Kjo përmirëson moralin e punonjësve për t'u përfshirë në procesin e vendimmarrjes, realizon bashkimin e interesave të veçanta dhe e kthen integrimin e tyre në një qëllim të vetëm.

Rrit efikasitetin - decentralizimi e vë theksin në kujdesin dhe në qasjen entuziaste për punën që rezulton në rritjen e efikasitetit dhe prodhimit. Kjo është e mundur sepse ai përfshin delegimin e autoritetit dhe përgjegjësisë dhe krijon mundësi për fizibilitetin e planifikimit afatgjatë (ndarja e nevojave momentale në njësitë e përbërjes).

Lehtëson diversifikimin - decentralizimi ndihmon në diversifikimin e aktiviteteve sepse lehtëson diversifikimin e produkteve, aktiviteteve, tregjeve etj. Një ndërmarrje e centralizuar me autoritet të përqendruar në krye, do të hasë vështirësi të natyrave të ndryshme për të diversifikuar aktivitetin e saj dhe do të fillojë një linjë të re të prodhimit ose të shpërndarjes. Decentralizimi rrit më shumë mundësitë e punësimit për shkak se menaxherët e rinj ngarkohen me detyra të reja. (Merko, Decentralizimi fiskal, financimi dhe shërbimet publike në Republikën e Maqedonisë, 2017).

Decentralizimi gjithashtu ka edhe disavantazhet e veta. Disavantazhet e decentralizimit janë:

- a. pabarazitë ndër-rajonale;
- b. pabarazi ndërmjet të ardhurave të disponueshme dhe funksioneve të mandatuar të qeverisë lokale;
- c. rritë riskun që burimet / fuqitë “të pushtohen” nga elita lokale ose grupe specifike në interes të tyre;
- d. fragmentarizime të tepruara.

Njohja e disavantazheve është e rëndësishme për të kuptuar faktorët që vështirësojnë procesin dhe njëkohësisht për të marrë masat e duhura për eliminimin në kohë të tyre, kur është e mundur. (Gollaj, 2013).

4. Komunat si institucione demokratike

Një komunë zakonisht është një ndarje e vetme administrative urbane që ka statusin e korporatës me kompetencat e vetëqeverisjes ose juridiksionit të dhënë nga ligjet kombëtare dhe shtetërore ndaj të cilave është e nënshtruar. Dallohen (zakonisht) nga qarku, të cilat mund të përfshijnë territorin rural ose shumë komunitete të vogla siç janë: qytetet dhe fshatrat.

Vetqeverisja lokale është autoritet për të përcaktuar dhe ekzekutuar masa brenda një zone të kufizuar apo më të vogël nga një shtet i tërë. Disa shkallë të vetqeverisjes lokale karakterizojnë çdo vend në botë, edhe pse shkalla është shumë e rëndësishme. Varianti, qeverisje lokale, është i rëndësishëm për theksin e tij në lirinë e lokalitetit për të vendosur dhe vepruar. Ka më shumë se një rëndësi teknike në dallimin në mes dy termave, sepse ato lidhen me dallimin që nganjëherë bëhet në mes dekoncentrimit dhe decentralizimit. Qeverisja lokale, shpesh, por jo domosdoshmërisht, lidhet me decentralizimin. Këto dallime janë të rëndësishme, edhe nëse janë të paqarta. Dekoncentrimi do të thotë se disa funksione janë transferuar nga një qeveri qendore në administratë vendore. Fuqia e kompetencave administrohet përmes zyrtarëve të emëruar dhe përgjegjësve nga niveli qendror. Autoriteti dhe liria e zgjedhjes poashtu i takon pushtetit qendror. Nga ana tjetër, decentralizimi përfaqëson qeverisjen vendore, në fushat ku autoriteti për të vendosur është transferuar në një këshill të personave të zgjedhur vendor⁴.

Qeverisja lokale është administrata publike e qyteteve, qytezave, qarqeve dhe rretheve. Ky lloj i qeverisjes përfshin strukturat e qarkut dhe qeveritë komunale. Organizimi i qeverisjes vendore ndryshon në varësi të shtetit. Megjithatë, të gjithë qeveritë lokale marrin autoritetin e tyre nga shteti në të cilin ndodhen.

Kur pyesim veten se çfarë është bashkësia lokale, duhet që të përcaktojmë kuadrin më të kapshëm të asaj që po kërkojmë dhe asaj që po përpiqemi ta bëjmë e ta përkufizojmë. Me termin "bashkësi lokale" ose "komunë", mendojmë para së gjithash në bashkësinë reale shoqërore që ka lindur për nevojat jetësore të njerëzve në një proces të egër afatgjatë. Kjo bashkësi dallon dukshëm nga bashkësia e krijuar artificialisht, e cila lind me marrëveshje të ndërsjellë dhe shërben kryesisht për kryerjen e punëve administrative dhe ligjore - dhe quhet komunë. Bashkësia juridike administrative ose komuna mund të përshtatet shpejt në forma të ndryshme në varësi të botëkuptimeve aktuale të pushtetit, marrëveshjeve, orientimit politik dhe të ngjashme. Komuna mund të jetë shumë e vogël, ose mund të jetë tepër e madhe në varësi nga

⁴ <https://www.britannica.com/topic/local-government> (Qasje më 29.11.2018)

territori dhe numri i banorëve që ajo përfshin. Madhësia e saj varet nga qëllimi të cilin ne duam të arrijmë përmes saj: demokraci, funksionalitet apo diçka të tretë.

Ndryshe nga bashkia, bashkësia lokale (komuna) nuk mundet të përshtatet lehtë dhe thjesht. Ajo ka lindur për arsye të çështjeve serioze jetësore. Prandaj, ajo bashkësi është shumë më e fortë dhe më rezistuese ndaj ndryshimeve, shumë më komplekse dhe më e vështirë për t'u përcaktuar. Duke e studiuar këtë bashkësi jetësore të njeriut nga sfera e qytetërimit teknologjik dhe integritetit të tij në kuadër më të gjerë, ne po studiojmë një dukuri shoqërore kyçe të jetës së njeriut. Këtë bashkësi mund ta quajmë me emra të ndryshëm.

Mund ta quajmë komunë. Ky term është shumë i zakonshëm në literaturën tonë dhe atë botërore, megjithëse disi sfidues kur mendojmë rreth zgjidhjeve normative. Bashkësia lokale është gjithashtu një shprehje e mirë, e përdorur shpesh në literaturë, por edhe ajo gjithashtu ka mangësi në radhë të parë sepse është mjaft e gjerë dhe e megjulluar. Ata që nuk pajtohen me disavantazhet e termave ekzistues mund të kënaqen me përkrahimin e asaj që kërkohet. Ne, pra, po e përsërisim edhe një herë, kërkojmë kuptimin e bashkësisë më të vogël territoriale jetësore të njeriut në qytetërimin evropian perëndimor (baza e kuptimit të saj, funksionet e saj më të rëndësishme, marrëdhëniet midis individit dhe institucioneve, cilat nevoja ajo i kënaq etj.). (Sergejev, 1978)

Radomir Lukic⁵ jep një analizë shumë interesante dhe të mprehtë për marrëdhëniet midis komunave dhe vendbanimeve. Komuna është para së gjithash një lloj vendbanimi. Çfarë është ky vendbanim? Afërsia dhe largësia nuk mund ta shpjegojnë vendbanimin për shkak se rrugët e të njëjtit qytet mund të veçohen dhe t'u përkasin për shembull njësive të ndryshme. Shtëpitë e afërta mund t'u takojnë pikave të largëta të vendbanimeve të ndryshme, ndërsa shtëpitë shumë të largëta të ndonjë fshati malor mund t'i përkasin së njëjtës tërësi. Vendbanimi, pra, nuk është, në thelb, territorial, por përbëhet nga procese sociale të bashkëpunimit në një territor të caktuar.

⁵ Radomir Lukić: "O definiciji Općine", Gledišta, Beograd, VI/1965, nr. 2, fq. 183 - 194.

Komuna është një lloj i veçantë i vendbanimit që lind vetëm në nivelin më të lartë të ndarjes së punës. Ajo mundëson përmbushjen e nevojave njerëzore dhe lë vetëm disa nevoja për t'u plotësuar në nivele më të ulëta. Socializimi është detyrë e komunës dhe zhvillimit të gjithanshëm të njeriut. Komuna duhet ta ekuilibrojë njeriun me shoqërinë. Ajo duhet të mundësojë që njeriu t'i realizojë nevojat e tij në një mënyrë të patjetërsueshme. Ideali i komunës duhet të jetë baza e krijimit të bashkisë së ardhshme. Në të ardhmen, komunat do të rriten. Në to sërish do të ringjallen komunitetet familjare dhe jo-territoriale, që lidhet me rënien e ndarjes së punës për shkak të automatizimit. Në punën e R. Lukic, gjejmë shtjellim shumë interesant. Këtu vërehet një konkluzion i saktë se vendbanimi nuk mund të shpjegohet si territor, por si marrëdhënie njerëzore.

Komuna është një formë e veçantë e vendbanimit, ose me fjalë të tjera, një formë e veçantë e marrëdhënieve njerëzore dhe bashkëpunimit. Sigurisht, ekziston edhe pyetja se si janë këto forma bashkëpunimi. A mund që këto procese shoqërore të bashkëpunimit, të cilat e përbëjnë thelbin e komunës, të numërohen dhe të përcaktohen? Me këtë përcaktim do të zgjidhim aspektin më interesant të problemit që e kemi parashtruar.

Josip Županov⁶, dallon në diskutimin e tij dy lloje të përkufizimeve: normative dhe sociologjike. E para është filozofike ose sociale filozofike me disa mangësi të caktuara. Por do të ishte gabim po ta anashkalonim krejtësisht sepse kjo përjashton aktivitetin si një formë revolucionare të veprimit shoqëror. Përkufizimet sociologjike janë më shkencore duke e shpjeguar komunën si “fakt social”, e cila mund të parashikojë ndryshime (në atë që J. Zhupanov pajtohet me Hagenin) vetëm brenda një modeli të qëndrueshëm. Komuna nuk është shoqëri në një format të vogël. Sot, njerëzit në entitete më të mëdha, dhe në veçanti në një shoqëri globale, lidhen përmes një sërë momentesh.

⁶ Josip Županov: »O problemima sociološke definicije opstine«, Naše teme, Zagreb VI/1962 nr. 2, fq. 235—251.

Shfaqja e komunës është komplekse, sikurse çdo fenomen tjetër shoqëror. Konceptet tona (hartat) nuk janë të njëjta me gjërat (territoret). Kjo është arsyeja pse rruga është e gjatë deri te modeli analitik. Është e dobishme për ta përdorur këtu modelin ideor të F. S. Nadel-ës. Ai dallon dy aspekte ose dy dimensione sociale. Njëri ka të bëjë me kushtet e veprimit shoqëror dhe tjetri mbi kriteret e marrëdhënieve midis individëve. Në të gjithë komunën duhet të studiohen, në pika të zgjedhura: nevojat njerëzore, kushtet për veprim (strukture, organizative, subjektive), veprimet e mbetura sociale, grupi dhe integrimi i tij. Në diskutimin e J. Županit gjejmë mendime interesante. Është shumë i rëndësishëm theksi i tij mbi dallimet në mes të pjesëtarëve të shoqërisë në komunë si një tërësi. Me të vërtetë, një shoqëri e madhe ka zhvilluar shumë forma të aktivitetit që ne nuk mund t'i gjejmë në komunë. Kjo është diçka për të menduar. Është gjithashtu e rëndësishme për të theksuar kompleksitetin e komunës si një fenomen shoqëror dhe përpjekjen për të përcaktuar atë kompleksitet. Megjithatë, në pyetjen themelore se cili është lloji specifik i vendbanimit që ne e quajmë komunë, sipas së cilës ajo dallon dukshëm nga të gjitha vendbanimet e tjera, nuk gjejmë një përgjigje të plotë.

Në prezantimin e tij është problematike diferencimi social i përkufizimeve filozofike (normative) dhe sociologjike të komunës, të cilat i shqyrtojnë “faktet shoqërore”. Ka pak filozofë të mëdhenj që kanë trajtuar çështje shoqërore, por sigurisht midis më të mëdhenjve në epokën e re mund të llogarisim Spinozën dhe Hegelin; dhe pikërisht ata kanë vendosur një detyrë se të menduarit që përpiqet për të vërtetën duhet të bazohet në atë që është ndryshe nga ajo që duhet të jetë. Komuna është një bashkësi reale shoqërore në një territor të caktuar, për dallim nga një bashki që është një komunitet administrativ-juridik – thekson në fillim të diskutimit të tij Zdravko Mlinar⁷. Njerëzit domosdo hyjnë në komunë dhe ata e kalojnë pjesën më të madhe të jetës së tyre në të. Komuna është sistem i grupeve të varura funksionale dhe njësive të specializuara. Ajo është “një komunitet social koheziv, i strukturuar dhe i lëvizshëm, i përbërë nga banorë të një territori të caktuar, të cilët për të kënaqur nevojat e tyre materiale dhe të tjera zhvillojnë aktivitete të ndryshme duke hyrë kështu në marrëdhënie reciproke dhe duke krijuar me këtë rast një kulturë të përbashkët”.

⁷ Zdravko Mlinar: »Aspekti sociološke definicije opštine«, Naše teme, VI /1962 nr 2 fq. 228 - 234.

Kuptimi i komunës mund të shpjegojë tetë terma analitikë: njerëzit dhe hapësirat, nevojat e njerëzve, aktivitetet (veprimtaritë, funksionet), marrëdhëniet e ndërsjella dhe komunikimet, elementet e kulturës (normat, vlerat, qëndrimet), strukturën shoqërore, angazhimin shoqëror, kohezionin (integrimin). Çdo element mund të luajë rolin e arsyes. Së fundi e vendosë hipotezën sipas së cilës përcaktohet niveli i ndarjes së punës rreth mënyrës dhe fushës së unifikimit të njerëzve në hapësirë gjeografike dhe shoqërore.

Elementet e hipotezës së përgjithshme janë: sa më e madhe që është shkalla e ndarjes së punës, aq më e madhe është hapësira gjeografike e komunës, aq më shumë janë të profilizuara nevojat e njerëzve, aq më i madh është disperzioni i kontakteve shoqërore, aq më e fragmentuar dhe heterogjene është kultura, aq më kompleks është diferencimi shoqëror dhe struktura e shoqërisë, aq më intensive është mobiliteti midis degëve të ndryshme të veprimtarive, aq më e lartë është shkalla e integritetit funksional të komunës.

5. Konkluzion

Në këtë kapitull arrijmë të kuptojmë se decentralizimi luan një rol shumë të rëndësishëm, si në dimensionin politik ashtu edhe në atë ekonomik. Transferimi i autoritetit nga pushteti qendror në pushtetin lokal ndihmon shumë në zhvillimin e mëtutjeshëm të nivelit lokal në raport me qytetarët që puna e tyre të jetë më e lehtë në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme. Me decentralizimin rritet dukshëm morali dhe motivimi i të punësuarve, nga fakti se autoriteti delegohet nga pushteti qendror në atë lokal. Decentralizimi ndihmon shumë që pushtetit lokal t'i jep hapësirë apo t'i mundësojë rritje efikasitetit të prodhimit dhe kështu komunat të marrin vendime që do të ndikojnë pozitivisht te të punësuarit në nivel lokal me ç'rast qytetarët do të avancohen në punën dhe veprimet e tyre gjatë aktiviteteve që do t'i ndërmarrin. Pra, decentralizimi është një faktor i rëndësishëm i demokratizimit të rendit ligjor, u jep qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur më shumë pushtet në marrjen e vendimeve.

KAPITULLI II - DECENTRALIZIMI POLITIK

1. Hyrje

Në këtë kapitull trajtohen çështje që kanë të bëjnë kryesisht me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit (MKO), dimensionin e tij politik dhe ekonomik, marrëdhëniet ndëretnike në mes dy etniteteve më të mëdha në Republikën e Maqedonisë, shqiptarëve dhe maqedonasve. Gjithashtu flitet edhe për përfaqësimin e drejtë të palëve nëpër institucione, mosdiskriminimin, arsimimin dhe përdorimin e gjuhëve në shkallë të barabartë, ndërprerjen e armiqësive në mes dy etniteteve si dhe zhvillimin e pushtetit të decentralizuar.

2. Marrëveshja Kornizë e Ohrit

MKO erdh si rezultat i mospajtimeve midis palëve në mes Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe forcave të sigurisë së shtetit, që më pas rezultoi me një marrëveshje për paqe mes të dy palëve nga blloku shqiptar dhe ai maqedonas. MKO u nënshkrua në Ohër më 13 Gusht 2001.

Marrëveshja është e ndërtuar mbi 5 parimet themelore, të cilat u bashkëshoqëruan me ndryshimet kushtetuese, që konfirmuan shoqërinë shumë-etnike në Maqedoni dhe ku u sanksionua se shqiptarët janë etni shtetformuese.

Marrëveshja kornizë synonte zhvillimin e qetë dhe harmonik të shoqërisë maqedonase duke respektuar njëkohësisht identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë. Kjo garantohej përmes përmbajtjes së saj ku decentralizimi ishte ndër pikat kryesore pasi siguronte qeverisjen e tyre nga bashkësia më e madhe e popullatës që e përbën.

“Marrëveshja e Ohrit detyron autoritetet e qeverisjes qendrore të garantojnë përfaqësimin e drejtë dhe mosdiskriminimin.” E reflektuar në ligj kjo pikë e marrëveshjes kërkonte që në

punësimet në administratën publike të sigurohej përfaqësimi i drejtë i bashkësive në të gjitha organet qendrore dhe lokale publike dhe në të gjitha nivelet e punësimit në këto organe.⁸

Këtu morën pjesë shumë figura të njohura botërore, organizata qeveritare si dhe shumë politikanë e njerëz të ndritur që dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim, me të vetmin qëllim që me këtë marrëveshje politike t'u jepet fund mospajtimeve në mes etniteteve; të ketë zhvillim ekonomik me të cilin shteti do të funksionojë lirshëm dhe popullata në R.M. do të jetojë në harmoni mes dy etnive më të mëdha (shqiptarëve dhe maqedonasve), duke respektuar identitetin etnik si dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Kjo kontratë e të dy popujve u bë e mundshme pas konfliktit të armatosur, që ndodhi në vitin 2001. Marrëveshja u realizua me ndihmën e Bashkësisë ndërkombëtare e cila dha kontributin e vet për zgjidhje politike të krizës ndëretnike në IRJM. Roli i Bashkësisë Ndërkombëtare për ndërprerjen e konfliktit dhe arritjen e marrëveshjes politike ishte i pazëvendësueshëm.

Qysh gjatë zhvillimeve luftarake në IRJM, Unioni Evropian dhe SHBA-të, dërguan përfaqësuesit e tyre: Francois Leotard dhe James Perdew, si ndërmjetësues për arritjen e paqes.

Pas negociatave të mundimshme me palët e konfrontuara, ata përgatitën dokumentin e ashtuquajtur "Versioni Draft i Dokumentit Kornizë", të cilin më 7 korrik 2001, ua dorëzuan katër liderëve, pjesëmarrës në Qeverinë e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe presidentit Trajkovski. Gjatë zhvillimit të negociatave në Ohër, faktori politik shqiptar startoi me pozicione euro-perëndimore. Ai nuk doli me kërkesa për ndarje territoriale, por për barazi të plotë etnike, që ishte në harmoni me parimet europerëndimore. Në fakt, kërkohej që karakteri multietnik i shoqërisë maqedonase të pasqyrohet në rregullimin shtetëror.

⁸ Marrë nga <https://www.gazetaexpress.com/lajme/cfare-eshte-marreveshja-e-ohrit-28376/?archive=1> (Qasje më 19.9.2018)

Ndërkaq, pala maqedonase mbante pozicion ekskluziv duke refuzuar kërkesën që pasqyronte diversitetin objektiv të shoqërisë në konceptin e shtetit. Ose me fjalë tjera, përderisa pala maqedonase synonte të kontrollojë të drejtat kombëtare të shqiptarëve, pala shqiptare nuk ndërhynte në korpusin e të drejtave të maqedonasve.

Fundi i negociatave shqiptaro-maqedonase ishte Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Në momentin kur pritej që negociatat e Ohrit të marrin fund, qarqe të caktuara nacionaliste, qeveritare dhe joqeveritare maqedonase filluan të japin deklarata të pamatura, të cilat shkaktuan reagime të ashpra të përfaqësuesve ndërkombëtarë. Këto deklarata përpiqeshin të minojnë procesin politik dhe projektin e marrëveshjes së hartuar nga ekspertët ndërkombëtarë. Por, qendrat e vendosjes ndërkombëtare ia bënë me dije palës maqedonase se: “Rrugëdalje më të mirë, pos pajtimit dhe nënshkrimit të këtij dokumenti nuk ka”.

Negociatat shqiptaro-maqedonase, në Ohër, zgjatën rreth dhjetë ditë dhe përfunduan më 13 gusht 2001. Nën tryshinë ndërkombëtare, konflikti shqiptaro-maqedonas u mbyll me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit.

Ajo u nënshkrua në Shkup, nga përfaqësuesit shqiptarë dhe maqedonasë, që merrnin pjesë në koalicionin e zgjeruar qeveritar: Lupço Georgievski, Arbër Xhaferi, Branko Cërvenkovski dhe Imer Imeri. Këtë marrëveshje e nënshkroi edhe kryetari i shtetit, Boris Trajkovski dhe ndërmjetësuesit euro-amerikanë, Leotard dhe Perdew. (KOHAnet, 2014)

Përfaqësimi në Gjykatën Kushtetuese kërkohet të bëhet mbi proporcionin e përfaqësimit në Kuvend sipas etnive. Shqiptarëve që përbëjnë mbi 30 % të popullsisë në Maqedoni, përmes Marrëveshjes së Ohrit, u garantohej e drejta e përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase. Atyre, gjithashtu, u garantohej edhe e drejta e përdorimit të simboleve kombëtare.

Derisa Marrëveshja e Ohrit ishte një kontratë juridike, kapitujt e të cilës parashihnin afate konkrete, shqiptarët, faktori politik shqiptar, raportet ndërkombëtare, përfaqësuesit e vendeve perëndimore si dhe mediat, në mënyrë të vazhdueshme kanë denoncuar se asnjë prej angazhimeve të ndërmarra 14 vjet më parë nuk është realizuar plotësisht.

Punësimet, përfaqësimi në institucione, pushteti vendor, gjuha dhe simbolet kombëtare dhe aq më pak ndalimi i diskriminimit nuk u arritën as në mënyrë të kënaqshme, shkaqe për të cilat shqiptarët janë shpesh në rrugën e protestës, pasi Marrëveshja e Ohrit nuk u siguroi atë që e kishte për obligim – shqiptarët, qytetarë të barabartë me maqedonasit. (Gazetaexpress, 2014).

3. MKO si model i zgjidhjes së marrëdhënieve ndëretnike

Në përgjithësi, Maqedonia ka bërë një përparim të dukshëm sa i përket përfshirjes së komunitetit shqiptar si dhe minoriteteve të tjera në vend. U bë ndarja e pushtetit, me ç'rast Maqedonia po ecte drejt rrugës duke i plotësuar kërkesat e nevojshme për anëtarësim në Unionin Evropian.

Të gjitha komunitetet në Maqedoni dëshirojnë ta shohin vendin në NATO dhe UE, ndërsa bashkësia ndërkombëtare ka bërë çmos që ta udhëzojë vendin në këtë drejtim.

Gjatë gjithë kohës, lidershipi maqedonas, duke përfshirë politikanët e të gjitha bashkësive etnike, në shumë raste janë treguar pragmatikë dhe kanë dëshmuar gatishmëri të plotë për të negociuar me partnerët e tyre në pothuajse çdo temë që kishte të bëjë me qëllime të përbashkëta përfitimi. Shpesh është gjetur një kompromis për të mirën e të gjithë qytetarëve.

Megjithatë, ka akoma shumë rrugë për t'u bërë, ndërsa lidershipi politik i vendit duhet të japë një pasqyrë më të qartë rreth vizionit konsensual dhe strategjisë për të ardhmen. (Plaks, 2011).

Marrëveshja Kornizë e Ohrit ka kontribuar në zgjidhjen e marrëdhënieve ndëretnike duke u bazuar në parimet e saja themelore si dhe në të gjitha aspektet ekonomike dhe politike, duke

mundësuar zhvillimin e marrëdhënieve më të afërta si dhe të integruara në mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë Euro-Altantike, si dhe duke respektuar identitetin etnik dhe interesat e gjithë qytetarëve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë.

4. Parimet themelore

- a. Tërësisht dhe pa kusht hedhet poshtë përdorimi i dhunës për realizimin e qëllimeve politike. Vetëm zgjidhjet paqësore politike mund ta garantojnë stabilitetin dhe ardhmërinë demokratike të Maqedonisë;
- b. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Maqedonisë dhe karakteri unitar i shtetit janë të pashkelshëm dhe duhet të ruhen. Nuk ekziston zgjidhje territoriale për çështjet etnike;
- c. Karakteri shumëtnik i shoqërisë maqedonase duhet të ruhet dhe të gjejë shprehjen e vet në jetën publike;
- d. Një shtet bashkëkohor demokratik, në rrjedhën natyrore të zhvillimit dhe krijimit të vet, duhet vazhdimisht të sigurojë Kushtetutën e tij që tërësisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të saj, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare si dhe të vetzhvillohen vazhdimisht;
- e. Zhvillimi i pushtetit vendor është me rëndësi thelbësore përnxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe për përparimin e respektimit të identitetit të bashkësive.

5. Ndërprerja e armiqësive

Palët e theksojnë rëndësinë e angazhimeve të 5 korrikut 2001. Do të ketë ndërprerje të armiqësive, çarmatim të tërësishëm vullnetar të grupeve të armatosura etnike shqiptare dhe shpërndarje të tërësishme vullnetare të tyre. Ata e pranojnë faktin se për marrjen e vendimit nga ana e NATO-s që të ndihmojë në këtë kontekst do të nevojitet vendosja e ndërprerjes së përgjithshme, pa kushte dhe të pakufizuar të zjarrit, pëlqimi për zgjidhjen politike të problemeve të këtij vendi, angazhimi i qartë i grupeve të armatosura që vullnetarisht të çarmatosen dhe

pranimi i të gjitha detyrimeve nga palët kontraktuese për kushtet dhe kufizimet, në kuadër të të cilëve do të veprojnë forcat e NATO-s.

6. Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar

- a) Do të miratohet Ligji i reviduar i pushtetit lokal, me të cilin do të forcohen autorizimet e përfaqësuesve të zgjedhur vendorë dhe dukshëm do të rriten kompetencat e tyre në pajtim me Kushtetutën (sikurse janë ndryshimet në pajtim me Aneksin A) dhe Kartën evropiane të pushtetit lokal, me ç'rast do të shprehet parimi i organizimit vertikal, i cili momentalisht është në fuqi në Bashkimin Evropian. Kompetencat e shtuara, para së gjithash kanë të bëjnë me sferat e shërbimeve publike, urbanistike dhe planifikimin rural, me mbrojtjen e ambientit të jetesës, zhvillimin ekonomik lokal, kulturën, financat lokale, arsimimin, mbrojtjen sociale dhe shëndetësore. Do të miratohet Ligji për financimin e pushtetit vendor me qëllim që të sigurohet sistemi përkatës i financimit, për t'u mundësuar autoriteteve vendore t'i plotësojnë të gjitha kompetencat e tyre.
- b) Brenda një viti pas përfundimit të regjistrimit të ri, i cili nën mbikëqyrjen ndërkombëtare do të zbatohet deri në mbarim të vitit 2001, do të revidohen kufijtë komunalë. Revidimi i kufijve komunalë do të zbatohet nga autoritetet lokale dhe nacionale, me pjesëmarrjen ndërkombëtare.
- c) Me qëllim që të sigurohet se policia është e vetëdijshme dhe përgjegjëse për nevojat dhe interesat e popullatës lokale, kryeshefat lokalë të policisë do t'i zgjedhin këshilltarët e komunave nga lista e kandidatëve, të propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe të njëjtit rregullisht do të komunikojnë me këshillat. Ministria e Punëve të Brendshme do ta mbajë autorizimin për shkarkimin e kryeshefave lokalë të policisë në pajtim me ligjin.

7. Mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë

- I. Tërësisht do të respektohet parimi i mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të të gjithë personave para ligjit. Ky parim do të aplikohet sidomos në raport me punësimet në administratën publike dhe në ndërmarrje publike, si dhe gjatë qasjes deri te financimi publik për zhvillimin e aktiviteteve afariste.
- II. Në ligjet me të cilët rregullohen punësimet në administratën publike do të përmbahen masat me të cilat do të sigurohet përfaqësimi i drejtë i bashkësive në të gjitha organet qendrore dhe lokale publike dhe në të gjitha nivelet e punësimit në këto organe, duke respektuar njëkohësisht rregullat e kompetencës dhe të integritetit, me të cilët udhëhiqet administrata publike. Autoritetet do të ndërmarrin aktivitete për ta korrigjuar mosekuilibrin ekzistues në përbërjen e administratës publike, sidomos përmes punësimit të pjesëtarëve të bashkësive me përfaqësim të pamjaftueshëm. Një vëmendje e posaçme do t'i kushtohet faktit që, sa më shpejtë të jetë e mundur, shërbimet policore në përgjithësi ta shprehin përbërjen dhe shpërndarjen e popullatës së Maqedonisë, sikurse është theksuar në Aneksin C.
- III. Për Gjykatën Kushtetuese, 1/3 e gjykatësve do të zgjidhet nga kuvendi me shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve që do ta përbëjë shumicën e numrit të përgjithshëm të deputetëve (të cilët pohojnë se i takojnë bashkësive që nuk janë popullate shumicë në Maqedoni). Kjo procedurë do të aplikohet edhe gjatë zgjedhjes së Avokatit Popullor dhe tre anëtarëve të këshillit gjyqësor.

8. Procedurat e posaçme kuvendore

- a. Në nivelin qendror, amendamentet kushtetuese dhe Ligji i Pushtetit Lokal, nuk do të mund të miratohen pa shumicën kualifikuese të 2/3 të votave, në kuadër të asaj që duhet

të ketë shumicën e votave të deputetëve të cilët pohojnë se u takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni.⁹

- b. Për nxjerrjen e ligjeve që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve, si dhe të ligjeve për financim lokal, zgjedhje vendore për qytetin e Shkupit dhe për kufijtë komunalë, do të duhet të ekzistojë shumica e votave në kuadër të asaj që duhet të ketë shumicën e votave të deputetëve që pohojnë se u takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni.¹⁰

9. Arsimimi dhe përdorimi i gjuhëve

- I. Lidhur me shkollimin fillor dhe të mesëm, mësimi do të zhvillohet në gjuhën amtare të nxënësve, e njëkohësisht në mbarë Maqedoninë do të aplikohen standardet e unifikuara për programet akademike.
- II. Financimi nga shteti do të sigurohet për arsimimin sipëror në gjuhët të cilat i flasin të paktën 20 për qind e popullatës në Maqedoni, e në bazë të marrëveshjeve të posaçme.
- III. Gjatë regjistrimit në universitetet shtetërore të studentëve të rinj të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë popullatë shumicë në Maqedoni do të aplikohet parimi i diskriminimit pozitiv, gjithnjë derisa regjistrimi nuk e shpreh si duhet përbërjen e popullatës në Maqedoni.
- IV. Në tërë Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase.¹¹
- V. Cilado gjuhë tjetër të cilën e flasin të paktën 20 për qind e popullatës, po ashtu është gjuhë zyrtare, sikurse është arsyetuar këtu. Në organet e Republikës së Maqedonisë, cilado gjuhë zyrtare tjetër nga maqedonishtja mund të përdoret në pajtim me ligjin, sikurse është elaboruar më tej në aneksin B. Cilido person që jeton në njësinë e pushtetit

⁹ Marrë nga Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit
http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf (Qasje më 25.09.2018)

¹⁰ Ibid.

¹¹ Marrë nga Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit
http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf (Qasje më 25.09.2018)

vendor në të cilin të paktën 20 për qind e popullatës flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga maqedonishtja mund të përdorë cilëndo gjuhë zyrtare për të komunikuar me zyrën rajonale të pushtetit qendror, kompetent për këtë komunë; zyra e tillë do të përgjigjet në atë gjuhë në mënyrë plotësuese në maqedonishte. Cilido person mund ta përdorë cilëndo gjuhë zyrtare për të komunikuar me zyrën kryesore të pushtetit qendror, e cila do t'i përgjigjet në atë gjuhë, në mënyrë plotësuese në maqedonisht.¹²

- VI. Lidhur me pushtetin vendor në komunat ku bashkësia e caktuar përbën të paktën 20 për qind të popullatës së komunës, gjuha e asaj bashkësie do të përdoret si gjuhë zyrtare, në mënyrë plotësuese - maqedonishtja. Në raport me gjuhët, të cilët flasin të paktën 20 për qind të popullatës së komunës autoritetet lokale në mënyrë demokratike do të vendosin për përdorimin e saj në organet publike.
- VII. Në procedurat penale dhe qytetare gjyqësore të cilitdo nivel, personi i akuzuar ose cilado palë do të ketë të drejtë të përkthimit në shpenzim të shtetit të të gjitha procedurave, si dhe të dokumenteve në pajtim me dokumentet përkatëse të Këshillit të Evropës.
- VIII. Cilatdo dokumente personale të qytetarëve që flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga maqedonishtja po ashtu do të lëshohen në atë gjuhë, në mënyrë plotësuese në gjuhën maqedonase në pajtim me ligjin.

10. Shprehja e identitetit

Lidhur me simbolet, pranë simbolit të Republikës së Maqedonisë, autoritetet vendore do ta kenë lirinë që në anën e parë të objekteve publike vendore të vendosin simbolet me të cilët shënohet identiteti i bashkësisë e cila është shumicë në komunë, me respektimin e rregullave dhe zbatimeve ndërkombëtare.

¹² Marrë nga Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit
http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf (Qasje më 25.09.2018)

11. Implementimi

- a. Amendamentet kushtetuese të propozuara në Aneksin A, menjëherë do të prezantohen para kuvendit. Palët do t'i ndërmarrin të gjitha masat për ta siguruar miratimin e këtyre amendamenteve në periudhën prej 45 ditë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje Kornizë.
- b. Miratimi i ndryshimeve në legjislacion, të përcaktuara në Aneksin B, do të jetë në pajtim me dinamikën e theksuar atje.
- c. Palët i bëjnë thirrje komunitetit ndërkombëtar, që sa më shpejtë ta thirrin konferencën e donatorëve në të cilën do të bisedohet para së gjithash për ndihmën makro financiare; përkrahjen e financimit të masave që do të ndërmerren për nevojat e implementimit të kësaj marrëveshjeje kornizë, duke përfshirë edhe masat e forcimit të pushtetit vendor; revitalizimin dhe ndërtimin e rajoneve të goditura nga luftimet.
(<http://www.siofa.gov.mk/>).

Marrëveshja Kornizë e Ohrit në pikën 1.5 parashikon: "zhvillimi i vetëqeverisjes lokale është thelbësor për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe për përparimin e respektimit të identitetit të bashkësive." Më konkretisht, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, në nenin 3, parashikon rritjen e kompetencave dhe burimeve për njësitë e vetëqeverisjes lokale, rishikimin e kufijve komunalë si dhe dispozitat për përzgjedhjen e shefave të policisë lokale.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit shprehimisht përmend pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën demokratike. Për shembull, financimi me pjesëmarrje në përgjithësi dhe në veçanti në fushat përkatëse për identitetin dhe realizimin e të drejtave të bashkësive mund të kontribuojë më tej për kohezionin social.

Si fillim i procesit të decentralizimit, katër ligje të mëdha janë miratuar në vitin 2002 dhe 2004: Ligji për Vetëqeverisje Lokale në vitin 2002; Ligji për Organizim Territorial të Vetëqeverisjes Lokale; Ligji për Qytetin e Shkupit dhe Ligji për Financim të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në vitin 2004; të gjithë me ndryshime të mëvonshme. Tre ligjet e tjera, që nuk janë përfshirë

drejtpërdrejtë në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit kanë kontribuar në drejtim të decentralizimit: Ligji për Bashkëpunim Ndërkomunal i vitit 2009, Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal i vitit 2007, si dhe Ligji për Inspektoriatin Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale i vitit 2010, të gjitha me ndryshime të mëtejshme.

Qëllimi i çdo decentralizimi është mbi të gjitha t'u mundësojë njësive të vetëqeverisjes lokale diskrecion në vendim-marrje dhe shpenzime, kështu që ato të mund t'i zhvillojnë politikatat lokale në pajtueshmëri me nevojat dhe prioritet e tyre. Pushteti qendror nuk ndan bllok dotacione të paparashikuara dhe të pabaza për të gjitha fushat. Kështu që njësitë e vetëqeverisjes lokale mund të vendosin për nevojat e tyre të infrastrukturës dhe për të menaxhuar shpenzimet e vazhdueshme, p.sh. përmes bashkëpunimit me njësitë e tjera të vetëqeverisjes lokale. Një rritje e fondeve jo-ndarëse mund të ketë ndikim pozitiv në efektivitetin e decentralizimit.¹³

Republika e Maqedonisë sa i përket procesit të decentralizimit të përmendur në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, mund të thuhet se ka përparuar në aspektin e qeverisjes së decentralizuar, në aspektin e një demokracie dinamike. Mirëpo, ka ngecur sa i përket procesit të decentralizimit fiskal, në kuptimin e shpërndarjes transparente dhe të barabartë të fondeve për njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Mekanizmat e mundshme për dialog dhe pjesëmarrje në shpërndarjen e fondeve nuk janë shfrytëzuar plotësisht.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit duhet të ishte një çështje e përfunduar para shumë vitesh, sepse viti 2004 ishte viti apo afati i fundit i përmbylljes së të gjitha fazave të implementimit dhe të gjithë anekseve të MKO, sidomos pjesës normative të ndryshimeve, ligjeve, akteve nënligjore dhe dispozitave të tjera juridike. Sipas meje, ka një neglizhencë nga ana e subjekteve politike në përmbajtjen e afateve për implementimin e MKO. Ka një dis'harmoni sa i përket pjesëve ligjore

¹³ Marrë nga Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, "Analiza e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit për kohezion social", <http://www.siofa.gov.mk/>, Shkup 2015.

që nuk janë zbatuar ende. Këtu e kam fjalën për mospërfaqësimin adekuat dhe të drejtë të bashkësive jo shumicë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Jo vetëm në pjesën normative të implementimit të Marrëveshjes, por edhe ngecjet tjera siç janë strukturat e administratës shtetërore dhe administratës publike. Nga kjo mund të shihet se nëpër shumë institucione, mbetet ende e papërfaqësuar në mënyrë proporcionale komuniteti shqiptar. Gjithashtu në këtë pjesë hyn edhe çështja e pazgjidhur e familjeve të viktimave dhe invalidëve të luftës që pësuan shumë në aspektin ekonomik, pasoja të cilat ende nuk janë kompensuar.

Ka edhe hallka të tjera të MKO-së të cilat ende nuk janë të përmbushura dhe shpeshherë kanë pasur efekte të kundërta. Këtu mund të përmendet dinamika dhe cilësia e procesit të decentralizimit të pushtetit dhe lënia pas dore e zhvillimit të pabarabartë dhe të padrejtë rajonal dhe ekonomik.

12. Konkluzion

Marrëveshja Kornizë e Ohrit nuk është zbatuar plotësisht. Ende ka probleme nga pikëpamja ekonomike dhe politike sa i përket decentralizimit në të dyja dimensionet, pra në atë politik dhe ekonomik. Pushteti qendror nuk ndan mjete të barabarta për nivelin lokal dhe kjo tregon se ka një pabarazi në shpërndarjen e mjeteve. Marrëveshja Kornizë e Ohrit nuk mund të jetë efikase dhe efektive pa u zbatuar procesi i tërësishëm i decentralizimit. Me zbatimin e decentralizimit qytetarëve do t'u mundësohen punësime të reja dhe niveli lokal do jetë më afër zgjidhjes së problemeve të qytetarëve nëse pushteti lokal fiton kompetenca më të mëdha për menaxhimin e punës drejt zgjidhjes së problemeve të natyrave të ndryshme si në arsim, shëndetësi, sport e tjerë.

KAPITULLI III - DECENTRALIZIMI EKONOMIK

1. Hyrje

Në këtë kapitull trajtohet decentralizimi në kuptimin e tij ekonomik; decentralizimi fiskal, zhvillimi i barabartë rajonal, ndarja e mjeteve për zhvillimin e barabartë rajonal, burimet e financimit të komunave siç janë: burimet vetanake të të ardhurave, dotacionet e mjeteve nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga buxhetet e fondeve dhe huamarrjet. Gjithashtu, këtu trajtohet çështja për perspektivat e decentralizimit fiskal, sistemi i financimit publik lokal si dhe vendndodhja e Republikës së Maqedonisë në këtë proces.

2. Decentralizimi ekonomik

Sipas bashkësisë së njësive të vetëqeverisjes lokale në Maqedoni (BNJVL 2013), decentralizimi ekonomik kryesisht kryhet dhe zbatohet me sjelljen e ligjeve, plotësimin dhe ndryshimin e tyre, ku në disa ligje përcaktohet puna e caktuar e cila rregullohet edhe me akte nënligjore ose me akte të cilat i miratojnë vet organet e komunës.

Disa strategji mund të ndiqen për ngritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve komunale, për shembull, vlerësimi i kapaciteteve komunale në aspektin e mbulimit të territorit ose konsumatorëve të shërbyer. Kjo do të ndihmonte në zgjedhjen e mënyrës më të mirë dhe më të lirë për ofrimin e shërbimeve (bashkëpunimit ndër-komunal me themelimin e ndërmarrjeve të përbashkëta, partneritetit publik - privat ose resurseve shtesë duke blerë shërbime nga kompanitë private ose nga ndërmarrjet komunale të komunës fqinje). Menaxhimi i borxheve momentalisht qëndron si një kërcënim serioz për ndërmarrjet komunale, një dukuri që e vështirëson komunikimin transparent dhe efikas ndërmjet kompanive dhe komunave. Ky problem duhet shpejt të merret në konsideratë, pa rrezikun e lënies anash të sektorëve që ndërlidhen me furnizimet themelore të popullatës, siç është p.sh. puna e furnizimit me ujë.


Për shembull, autoritetet qendrore mund të luajnë një rol ndërmjetësues dhe mundësisht të aftësojnë komunat të marrin kredi prej bankave komerciale nën kushte të preferuara. Kjo është e nevojshme sepse borxhet e vjetra të ndërmarrjeve komunale e bllokojnë llogarinë e ndërmarrjeve. Kjo e bllokon punën e ndërmarrjeve sepse pamundëson pagesat e rregullta. Si shtesë, borxhet e ndërmarrjeve rriten për shkak të grumbullimit të përqindjes së interesit që është shumë më i madh se interesi i kredive bankare.

Mundësimi i kredive bankare me qëllim të riprogramimit të borxheve ekzistuese do të mundësonte disa përfitime. Me shfrytëzimin e kredive bankare ndërmarrjet dhe komunat do të jenë të afta që të ripërcaktojnë orarin e borxheve të tyre dhe të planifikojnë pagesën e tyre me këste. Pagesa e kësteve do të planifikohej në buxhetin e ndërmarrjeve dhe nuk do të bllokonte llogarinë në bankë. Kjo do të siguronte ofrimin e pandërprerë të shërbimeve dhe shpenzimeve më të ulëta të ndërmarrjeve dhe në të njëjtën kohë edhe të komunës. Themelimi i këshillit komunal të shfrytëzuesve do të mund t'u ndihmonte komunave në përmirësimin e komunikimeve me qytetarët. Këshilli do të shërbejë si një forum për diskutimin e grumbullimit të taksave dhe negociatave për çmimet përkatëse lidhur me cilësinë e dëshiruar të shërbimeve. (OSCE, 2008).

Aspekti i borxheve të disa komunave që janë të bllokuara ekonomikisht ka ndikuar në mosrealizimin e shumë projekteve dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me qytetarët. Mirëpo, qeveria e Republikës së Maqedonisë me ribalancin e buxhetit solli vendim që t'ua shlyejë borxhet komunave, që do të thotë se shteti ua fali gjysmën e borxheve komunave të cilat kishin ngarkesë më të madhe nga borxhet e marrura.

Pra, nga ribalanci i buxhetit qeveria e R.M., ndau 3,02 miliardë denarë të cilat janë të pakthyshme. Me këtë vendim të qeverisë forcohet kapaciteti fiskal i komunave si dhe servisimi i marrëveshjeve. Të dhënat e marra nga Mediaplus.org (nëntor 2017) tregojnë se komunat në Republikën e Maqedonisë kanë borxhe të pa paguara në vlerë rreth 5,5 miliardë denarë, prej të cilave me më shumë borxhe është komuna e Ohrit me – 20.921.528 milion euro; më pas vjen

komuna e Tetovës me – 10,413.295 milion euro, komuna e Strugës - 3,491.227 milion euro si dhe Kumanova me – 3,443.625 milion euro.



Buxheti i komunave do të mund të projektohet me 10 % maksimum rritje në krahasim me përqindjen nga të ardhurat e realizuara në tre vitet e fundit.

Kjo është masë që paraqet garancion se problemi me borxhin e komunave nuk do të përsëritet sepse, do të parandalohen akumulimet e obligimeve të papaguara dhe do të përmirësohet puna financiare e Komunave¹⁴.

Si mekanizëm mbrojtës nga borxhet e reja në të ardhmen, qeveria ka hartuar një projekt-ligj që parashikon kufizim të të hyrave të veta në buxhet të komunave; ato të mund të planifikohen me një rritje deri në 10 për qind nga të ardhurat mesatare të realizuara në tre vitet e fundit. Ndryshe borxhi i përgjithshëm i të gjitha komunave arrin pothuajse 100 milionë euro dhe qeveria ka vendosur të mbulojë 51% të kësaj shume, para që do të sigurohen nga rishikimi i buxhetit.

Me shlyerjen e borxheve nga ana e Qeverisë këto komuna sipas mendimit tim do të funksionojnë më lirshëm dhe do përpilojnë projekte për zhvillim kapital si dhe do ndihmohet në aspektin e lehtësimit të punës së qytetarëve. Kërkesat e tyre do të implementohen më lehtë dhe sistemi do funksionojë në dobi të vet qytetarëve dhe komunës. Kjo do të ndihmojë shumë në avancimin e kuadrove për të prodhuar ide inovative, thënë ndryshe administrata komunale do ta ketë më lehtë implementimin dhe menaxhimin e projekteve dhe sistemi apo zinxhiri i funksionimit të punës do jetë më efikas në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve.

¹⁴ Marrë nga PortAlb - <https://portalb.mk/571720-qeveria-do-ti-ndihmoje-komunat-ne-menyre-financiare-por-do-tua-kufizojte-borxhin/>, Qasje më: 15.12.2018.

3. Decentralizimi fiskal në R. M.

Aspekti financiar apo përgjegjesia financiare është një nga komponentët kyç të decentralizimit. Nëse pushtetet lokale duan që aktivitetet e decentralizuara t'i kryejnë me efektivitet atëherë ato duhet që të disponojnë të ardhura të mjaftueshme qoftë nga mjetet vetanake ose të transferuara nga pushteti qendror.

Sipas Rondinelli (1998) decentralizimi fiskal në përgjithësi mund të marrë shumë forma, që përfshijnë:

- vetë-financimin apo mbulimin e kostove nëpërmjet të ardhurave nga përdoruesit;
- bashkë-financimin apo bashkë-prodhimin, në të cilin përdoruesit marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve dhe infrastrukturës nëpërmjet kontributeve monetare dhe punës;
- shtrirjen e të ardhurave lokale nëpërmjet taksave mbi pasurinë apo nga shitjet ose të ardhurat indirekte;
- transfertat ndërqeveritare të të ardhurave të përgjithshme nga taksat e mbledhura nga pushteti qendror te pushteti lokal, për përdorim të përgjithshëm apo specifik;
- autorizimin e marrjes hua nga bashkitë dhe mobilizimin e burimeve kombëtare dhe të pushteteve lokale nëpërmjet garancive të huave. (Rondinelli, 1998)

Në fakt, thelbi i decentralizimit qëndron në çështjen se autoritetet lokale duhet të kenë autoritetin dhe përgjegjësinë për vetfinancimin e nevojave lokale të qytetarëve. Në parim, kjo do të thotë se, që të sigurohet autonomi e plotë fiskale është e nevojshme që niveli lokal të ketë të drejtën që të përcaktojë dhe të ndryshojë normat dhe tarifatatimore që në realitet nuk ndodh në rastin e Maqedonisë. Kjo e drejtë me një shkallë shumë të kufizuar u jepet komunave ku ligjet dhe konventat janë të miratuara dhe të pranuar nga qeveria të cilët sigurojnë të ardhura për komunat si: Ligji për tatimin në pronë, Ligji për taksat komunale dhe Ligji për taksat administrative. Ndërsa bazike është ligji mbi tatimet në pronën që përfshin tatimin në pasuri,

tatimin mbi trashëgiminë dhe dhuratën dhe së fundi tatimi mbi shitjet e pasurive të patundshme.

Duhet potencuar se ndarja e barabartë e fondeve është një parakusht për kohezionin social dhe gjithashtu buron nga dispozitat e jo-diskriminimit të përfshirë në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Për më tepër, Marrëveshja Kornizë e Ohrit shprehimisht përmend pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën demokratike. Për shembull, financimi me pjesëmarrje, në përgjithësi dhe në veçanti, në fushat përkatëse për identitetin dhe realizimin e të drejtave të bashkësive, mund të kontribuojë më tej për kohezionin social.

Në fillim të procesit të decentralizimit (në vitin 2002 dhe 2004), janë miratuar katër ligje të mëdha: Ligji për Vetëqeverisje Lokale në vitin 2002, Ligji për Organizim Territorial të Vetëqeverisjes Lokale, Ligji për Qytetin e Shkupit dhe Ligji për Financim të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale në vitin 2004, të gjithë me ndryshime të mëvonshme. Tre ligjet e tjera, që nuk janë përfshirë drejtpërdrejtë në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit kanë kontribuar në drejtim të decentralizimit: Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal i vitit 2009, Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal i vitit 2007 si dhe Ligji për Inspektoratin Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale i vitit 2010, të gjitha me ndryshime të mëtejshme.

Realizimi i decentralizimit fiskal u realizua në faza, duke u siguruar njësive të vetëqeverisjes lokale mjete për marrjen e kompetencave të tyre në varësi prej kriterëve të caktuar dhe të specifikuar, me rregullimin e financave (2007) dhe procesin e huamarrjes (2009). Deri në vitin 2012, të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale (përveç Komunës Pllasnicë) kishin kaluar në fazën e dytë të decentralizimit fiskal.

Sipas, Analizës së SIOFA, ndërmjet viteve 2005 dhe 2015, të ardhurat totale të njësive të vetëqeverisjes lokale u rritën nga 1.9% e BPV-së në 5.8%. Shuma e granteve kapitale për njësitë e vetëqeverisjes lokale është ulur mes viteve 2013-2015 nga 870.444.000 denarë - në 683.643.000 - ndërsa shpenzimet e përgjithshme kapitale u rritën (nga 20.154.000.000 denarë - në 22.234.000.000 denarë). Me fjalë të tjera, pjesëmarrja e granteve kapitale ka rënë nga 4.3%

në 3.1% mes viteve 2013-2015. TVSH-ja është burimi më i qëndrueshëm i të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes lokale. Shpërndarja e TVSH-së për vitin 2016 ishte 4.5% nga TVSH-ja e paguar në vitin 2015. Rreth gjysma e mjeteve të komunave janë nga dotacionet e qeverisë. Gjysma e mbetur është nga dotacionet jo të kushtëzuara, pjesë nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH-në) dhe tatimi i të ardhurave personale (TAP), taksave dhe tatimeve lokale si dhe të ardhurave jo-tatimore dhe jo-kapitale. Duke marrë parasysh kompetencat që komunat janë të obliguara t'i përmbushin, pjesa më e madhe e mjeteve të njësive të vetëqeverisjes lokale janë të kushtëzuara ose të dedikuara.¹⁵

Skema e financimit të komunave për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale realizohet si vijon:

1. Burimet e financimit të komunës mund të ndahen në:

- a. burime nga të ardhurat e veta;
- b. dotacione të mjeteve nga buxheti i R.M. dhe
- c. dotacione nga buxhetet e fondeve dhe të huazimit.

Burime nga të ardhurat e vetë komunës:

2. Burime nga të ardhurat e komunës mund të ndahen në nëngrupet vijuese:

- a. tatime lokale të përcaktuara me ligj;
- b. tatimi i pasurisë;
- c. tatimi i trashigimisë dhe dhuratës të përcaktuara me ligj;
- d. tatimi për qarkullimin e patundshëm dhe
- e. tatime të tjera lokale të përcaktuara me ligj.

¹⁵ Analiza e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit për kohezion social, fq. 17

Tatimi i pasurisë është obligim i çdo qytetari, pronar i pasurisë. Obligim i qytetarëve është që më së voni deri më 31 janar të vitit të dërgojnë lajmërimin tatimor për pasuri të re apo për informata të reja nëse ka ndryshime në gjendjen e pasurisë, deri te organi tatimor i komunës. Kryetari i komunës është i obliguar që të sjellë vendime për lartësinë e tatimit të pasurisë më së voni deri më 31 mars dhe të njëjtat t'i dërgojë deri te qytetarët. Shkalla e tatimit të pasurisë është 0,10%-0,20%, ndërsa përqindjen e saktë vjetore e përcakton këshilli komunal dhe ajo mund të ndryshojë çdo vit dhe të jetë me vlerë të ndryshme në komuna të ndryshme.

Gjatë vlerësimit të tatimit të pasurisë, për objektet në të cilat jeton tatimpaguesi, llogaritet lirim prej 50% nga vlera në treg. Kjo d.m.th. se në shtëpitë apo banesat në të cilat jetoni gjatë vlerësimit të tatimit, do të bëhet zbritje e çmimit, ndërsa për vikend-shtëpitë dhe për objektet të cilat i jepni me qira, tatimi do të vlerësohet me çmim të plotë të vlerës tregëtare. I rëndësishëm është fakti se me ndryshimin e ligjit për tatime nga 1 janar 2008, komunat fillojnë që ta administrojnë edhe tatimin e pasurisë së përgjithshme të personave juridik, që nuk ishte rast në të kaluarën.

Tatimi i trashëgimeve dhe dhuratave është përcaktuar sipas rendit të trashëgimisë. Shkalla e tatimeve që u përkasin dhuratave dhe trashëgimive nga rendi i dytë trashëgimor është 2% deri 3% ndërsa për trashëgimi të rendit të tretë 4% deri 5% të vlerës tregëtare të pasurisë, deri sa për trashëgim të rendit të parë nuk paguhet tatimi i dhuratës dhe trashëgimisë. Vendimi për lartësinë e shkallës së këtij tatimi poashtu është pjesë e përgjegjësisë së këshillave të komunave.

Tatimi i pasurisë së patundshme: Nëse vendosni ta shisni pasurinë tuaj apo të bleni pasuri, keni obligimin që komunës t'i paguani tatim. Shkalla e këtij tatimi sillet prej 2% deri 4%, nga vlera tregtare e pasurisë. Për lartësinë e shkallës vendos këshilli komunal.

Taksa lokale të përcaktuara me ligj:¹⁶

- I. taksa komunale,

¹⁶ Perishiq, D., & Angelov, G. (2008). Unë dhe Komuna ime. Shkup: ZELS.

- II. taksa administrative,
- III. taksa të tjera lokale të përcaktuara me ligj.

Taksat komunale paguhen për shfrytëzimin e disa të drejtave, mjeteve dhe shërbimeve për interes publik e që kanë karakter lokal. Obligim për pagesën e këtyre taksave kanë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari por edhe qytetarët.

Taksat komunale paguhen për:¹⁷

- çdo firmë të regjistruar (çdo firmë e regjistruar sipas ligjit, në vit paguan vlerë të caktuar në emër - taksë komunale - e njohur si firmarinë. Vendimet me sasinë e taksës dorëzohen deri te personat juridik në të njëjtën kohë me vendimet për tatim);
- shfrytëzimi i sipërfaqeve në kampet;
- shfrytëzimi i hapsirave para objekteve afariste;
- paraqitja e reklamave;
- shfrytëzimi i muzikës në lokalet publike;
- shfrytëzimi i shesheve për ekspozitë të mjeteve;
- shfrytëzimi i vendit për parkim.

Çdo person juridik apo fizik në vendin tonë, nëse do të shfrytëzojë sipërfaqe publike për aktivitete të ndryshme duhet patjetër të kërkojë leje nga komuna. Me këtë, por edhe sipas ligjit, komuna është e obliguar që të vlerësojë dhe t'ia dërgojë vendimin për pagimin e taksës komunale.

Të ardhura nga pasuria¹⁸

- i. të ardhura nga qiraja;
- ii. të ardhura nga kamatat dhe

¹⁷ Ibid

¹⁸ Ibid

- iii. të ardhura nga shitja e pasurisë me të cilën nuk rregullohen funksionet publike dhe kompetencat e komunave.

Çdo komunë që ka pronësi, ka të drejtë edhe të kryejë ekonomi me të njëjtën, gjegjësisht ta japë me qira, ta shesë por edhe të mbledhë të ardhura nga kamatat. Çmimin e çdo kategorie duhet ta përcaktojë këshilli komunal.

3. Dotacione nga mjetet e buxhetit të Republikës së Maqedonisë¹⁹

3.1. Të ardhura nga tatimi personal

Tatimi personal është kategori tatimi të cilin e mbledh shteti, ndërsa paguhet nga rrogat e banorëve të Republikës së Maqedonisë. Prej të gjitha sasive të mbledhura, 3% ndahen për komunat. Shpërndarja bëhet sipas vendbanimit, ashtu që nëse jetoni në komunën e Aerodromit e ndërsa punoni në komunën e Karposhit, mjetet nga rroga juaj do të derdhen në komunën e Aerodromit.

I njëjti rast është me çdo komunë në R.M. Ashtu që nëse punoni në Manastir e ndërsa jetoni në Resnjë, pjesa e tatimit personal nga të ardhurat e juaja do të shkojë në buxhetin e Resnjës. Në rastin e tatimit personal të të ardhurave të personave fizikë të cilat merren me veprimtari zejtarie, situata është ndryshe. Ai derdhet në kasën komunale në tërësi, gjegjësisht 100%.

3.2. Të ardhura nga tatimi i vlerës së shtuar

Çdo prodhim apo shërbim të cilin ju si qytetarë e bleni, në çmimin e saj përmban 18% tatim i ashtuquajtur tatim i vlerës së shtuar (TVSH). Ky tatim derdhet në buxhetin qendror ndërsa vetëm 3% nga vlera e përgjithshme e TVSH-së, i mbledhur në vitin paraprak, ndahet dhe shkon në komunat. Nga shpërndarja e TVSH-së nëpër komuna, përdoret formula (metodologjia) për

¹⁹ Ibid

përcaktimin e saktë të shumës të cilën duhet ta fitojë çdo komunë. Formula përcaktohet çdo vit për vitin e ardhshëm, ndërsa si pjesëtar i rëndësishëm i përcaktimit të saj paraqitet BNJVL-ja (Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Republikës së Maqedonisë).

Shuma e përgjithshme vjetore e TVSH-së për çdo komunë paguhet në 12 këste të njëjta mujore. Në 3 vitet e fundit ato përqindje të dedikuara për komunat janë ndarë sipas kritereve: 60% numri i banorëve, 27% - hapësirë dhe 13% - numër i vendeve të banuara.

3.3. Dotacione të dedikuara

Dotacioni i dedikuar shpërndahet nëpër komuna, projekte dhe institucione apo programe nga Ministria e Financave me propozim të ministrive përkatëse dhe fondeve për financimin e aktiviteteve konkrete. Kjo mënyrë është më e përdorura prej fillimit të decentralizimit dhe shfrytëzohet për financimin e një pjese të kompetencave të transferuara nga pushteti qendror në atë vendor.

Shembull për dotacionet e dedikuara janë: arsimi, punët sociale si dhe sporti e kultura. Me transferimin e një pjese të kompetencave, pushteti qendror, përveç objekteve dhe të punësuarve, duhej patjetër që të transferojë edhe një pjesë të mjeteve financiare për funksionimin normal të këtyre kompetencave. Me këto dotacione, në sferat e kompetencave të përmendura, financohet mirëmbajtja e objekteve, sigurimi me ngrohje, pagesa e shërbimeve komunale (ujë, rrymë etj.) si dhe transporti i nxënësve në pjesën e arsimit. Vetë e dotacioneve të dedikuara është se në vlerën e përgjithshme të sasisë që transferohet në komunat, saktësisht dihej se sa është paraparë për çdo aktivitet. Transferim p.sh. i mjeteve prej transportit në nxemje, nuk guxon të ndodhë. Vlerësimet se sa mjete do të transferohen për një komunë të caktuar i bën pushteti qendror, në bazë të harxhimeve historike, gjegjësisht, harxhimeve që ka patur qeveria në kohën kur ajo ka udhëhequr me kompetencat e përmendura.

3.4. Blok dotacione

Blok dotacione janë mjete që komunat i marrin drejtpërsëdrejti nga buxheti shtetëror e të cilat i shrytëzojnë për financimin e disa kompetencave të caktuara, gjegjësisht aktiviteteve konkrete, të marra me fillimin e fazës së dytë të decentralizimit. Për sasinë e këtyre dotacioneve, kompetente janë Ministritë përkatëse dhe Ministria e Financave. Shembuj të tillë kemi në kompetencat për shkollat fillore dhe të mesme, mbrojtjen sociale, kulturën, sportet dhe rekreimet, mbrojtjen shëndetësore primare. Dallimi mes blok-dotacioneve dhe atyre të dedikuara është se në blok-dotacionet hyjnë edhe rrogat e të punësuarve nëpër institucionet e decentralizuara si dhe fakti se mjetet në blok-dotacionet mund të derdhen. Gjegjësisht, nëse bëhet kursim në nxemje, mjetet mund të shfrytëzohen për riparim apo për investime më të vogla.

4. Dotacione nga buxhetet e fondeve dhe huazimeve

4.1. Dotacione kapitale

Dotacione kapitale, në bazë të programit të përcaktuar nga ana e qeverisë së R.M., shfrytëzohen për financimin e projekteve investuese. Komunat duhet të përgatisin projekte me kualitet dhe konstruksion plotësisht të mbyllur financiar, për punë që tejkalojnë mundësitë e tyre. Të tillë janë shembujt lidhur me ndërtimin e infrastrukturës rrugore, sistemeve të ujësjellësit, shkollave etj.

4.2. Huazimet e komunave

Në parim me ligjin për financimin e vetëqeverisjes lokale, komunat në fazën e parë të implementimit të decentralizimit, nuk kanë të drejtë të huazohen në bankat apo në subjektet e tjera. Këtë të drejtë komunat do ta kenë kur do të hyjnë në fazën e dytë të decentralizimit dhe kjo qasje do të jetë selektive e nuk do të vlejë për të gjithë. Kështu, deri në fund të vitit 2007 vetëm 51 komuna kaluan në fazën e dytë të decentralizimit. Të drejtën për huazim komunat e

përfituan prej datës 1 janar 2008. Lartësia e huazimeve të komunave nuk guxon të jetë më e madhe se 20% nga buxheti vjetor i komunës. Kushtet dhe të drejtat për të huazuar një komunë i përcakton Ministria e Financave, gjegjësisht komisioni i posaçëm i formuar për këtë qëllim, ku ka edhe përfaqësues të BNJVL-së. Kuptohet se vendimin për huazimin e sjell Këshilli komunal në propozim të kryetarit.

4.3. Të ardhura nga donacione

Të ardhurat nga donacionet janë të shpeshta gjatë viteve të fundit. Donacione fitohen për ndërtimin e infrastrukturës komunale, për ngjarjet kulturore, për festime të ndryshme dhe jubile. Donatorë më të shpeshtë janë organizatat e huaja dhe ambasadat, por edhe kompani të vendit dhe persona fizikë. Të gjitha format e përmendura janë forma të të ardhurave të komunës. Me taksat dhe tatimet e mbledhura në këtë mënyrë komunat kanë obligimin që t'i sigurojnë shërbimet ndaj qytetarëve të vet, ta sigurojnë rrjetën infrastrukturore, të ndërtojnë rrugë, kanalizime e ujësjellës, të kujdesen për zhvillimin ekonomik lokal, mbrojtjen nga zjarret, ndihmën sociale, të kujdesen për mjedisin jetësor, objektet sportive si edhe për shumë gjëra të tjera të cilat janë nën kompetencat e komunës. Për atë qëllim, në kuartalin e fundit të çdo viti, punëtorët komunalë punojnë në përpunimin e buxhetit dhe programit të cilin duhet ta realizojnë në vitin e ardhshëm. Aktivitetet programore i detektojnë në bazë të nevojave të qytetarëve ndërsa mjetet financiare në bazë të parashikimit të mjeteve të cilat duhet të mblidhen në emër të taksave dhe tatimeve. Një pjesë e mjeteve nga buxheti janë paraparë, në bazë të informatave të qeverisë, për mjete të mundshme që do të transferohen në komunat. Shpesh ndodh që Kryetari i komunës dhe administrata komunale të organizojnë debate publike për kompozicionin e aktiviteteve dhe buxhetin për vitin e ardhshëm. Shpeshherë këto debate publike mbahen në bashkësitë vendore e pastaj të gjitha mendimet e grumbulluara futen në planin e aktiviteteve dhe buxhetin e vitit të ardhshëm²⁰.

²⁰ Marrë nga Unë dhe Komuna ime, Doracak për procesin e Decentralizimit në Republikën e Maqedonisë, fq. 54, Shkup, 2008.
<http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/%D0%98%D0%B7%D0%B4%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0/AL/Publikacii/20UNE%20DHE%20KOMUNA%20IME.pdf>

5. Decentralizimi dhe zhvillimi i barabartë rajonal²¹

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë përdorur reformat e decentralizimit si një mjet për të gjetur zgjidhje për çështjet kombëtare që kanë dalë si pasojë e konflikteve ndëretnike dhe si nevojë për të zvogëluar kompetencat e tepruara të centralizimit të trashëguara nga regjimet e mëparshme socialiste. Në anën tjetër, decentralizimi mund të jetë një proces kundërthënës. Gjatë zbatimit, qeveritë qendrore ngurrojnë të bartin pushtetin me argumentin se qeveritë lokale akoma nuk janë në gjendje që t'ia dalin me kompetencat e reja të tyre, në anën tjetër, komunat kërkojnë më shumë përgjegjësi në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat e qytetarëve për ofrim të shërbimeve.

Faktet e decentralizimit në Maqedoni tregojnë se kjo reformë publike është një proces afatgjatë dhe jo një intervenim që mund të arrihet plotësisht në një afat kohor të caktuar nga vendimmarrësit vendorë apo faktori ndërkombëtar. Deri më tani, decentralizimi ka pasur efekte pozitive, sidoqoftë, suksesi i decentralizimit varet në rend të parë nga dy faktorë kryesorë: përkrahja e qeverisë qendrore dhe reagimi i duhur i qeverive lokale dhe qytetarëve. Për më tepër, organizatat ndërkombëtare të cilat e kanë shtyrë aq shumë këtë proces në fillim, akoma kanë punë për të kryer, veçanërisht me resurse dhe intervenime konkrete.

Megjithatë, ka një anë tjetër të decentralizimit e cila është më pak politike e më shumë praktike. Qëllimet e decentralizimit shkojnë përtej parimeve të gjëra të vetëqeverisjes dhe përfaqësimit politik të komuniteteve lokale. Ato po ashtu kanë për qëllim që shërbimet publike t'i ofrojnë më afër qytetarëve, duke u siguruar që të njëjtat janë të ofruara me efikasitet dhe me përgjegjshmëri në mënyrë që t'u shkojnë për shtati nevojave të komunitetit lokal duke e përmirësuar jetën dhe mirëqenien e njerëzve që jetojnë atje. Pikërisht këto janë sfidat aktuale të decentralizimit në Maqedoni; qëllimet politike të decentralizimit nuk mund të përmbushen në mënyrën e duhur pa pasur vëmendjen tek ofrimi efikas i shërbimeve publike.

²¹ <http://www.struga.gov.mk/wp-content/uploads/2018/04/Ligji-per-zhvillimin-e-barabarte-rajonal.pdf>

Po ashtu të vetëdijshëm për përfitimet nga politika zhvillimore regjionale e Unionit Evropian, sfida jonë e ardhshme është bashkëpunimi ndërkufitar me të gjithë fqinjët tanë: Shqipërinë, Kosovën, Bullgarinë dhe Greqinë, si dhe shfrytëzimi i mundësive dhe fondeve që i ofron programi IPA dhe programi transnacional i Evropës Juglindore, me qëllim që politikën për zhvillim të barabartë regjional ta vendosim në kontest të asaj evropiane.

Megjithatë, procesi i decentralizimit pengohet ende nga disa kufizime. Me gjithë rritjen e besimit në pushtetin vendor dhe faktit se disa komuna kanë mundur të arrijnë rezultate të prekshme në ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin urban, implementimi i reformave për të decentralizuar me sukses vendimet fiskale dhe administrative nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe e vonuar me afatet. Ka akoma dobësi institucionale dhe kapacitet të ulët implementimi i cili kufizon zërin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punët vendore, sikurse edhe në transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverive vendore. Rezistenca politike dhe pengesat burokratike bllokojnë dhe vazhdojnë të vonojnë hapin e decentralizimit. (Sela, et al., 2013).

Procesi i decentralizimit në Maqedoni u ka mundësuar shumë kompetenca njësive të vetëqeverisje lokale (NJVL) dhe për përmbushjen e tyre sipas parimeve të Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale komunave u janë dhënë burime përkatëse të mjeteve financiare. Një pjesë e madhe e autorëve pajtohen se decentralizimi fiskal paraqet bazë për çfarëdo forme të decentralizimit si në vendet e zhvilluara njashtu edhe në vendet në zhvillim, të cilat aspirojnë të arrijnë demokratizim të shoqërive të tyre.

Njëra ndër dispozitat themelore të nenit 9 të Konventës evropiane për vetëqeverisje lokale të Këshillit të Evropës është: burimet e mjeteve duhet të jenë adekuate me detyrimet e reja; një pjesë e burimeve të burojnë nga tatimet lokale dhe kompensimet, që në bazë të ligjit vetë (komunat) e përcaktojnë shkallën tyre, si dhe burimet e mjeteve duhet të jenë në numër të mjaftueshëm dhe elastikë. Prandaj për decentralizim efikas të kompetencave në raport me të ardhurat së paku duhet të sigurohen kriteret themelore minimale:

- i. resurset e mjaftueshme të autoriteteve lokale për përmbushje të kompetencave të përcaktuara me ligj;
- ii. shpërndarja e të ardhurave të mundësojë shkallë të caktuar të autonomisë në grumbullimin e të ardhurave nga pushteti lokal;
- iii. sistemi mirë i përcaktuar i tatimeve lokale, i cili do të sigurojë lidhje ndërmjet komunës dhe sferës në të cilën financohen shërbimet nga ai tatim;
- iv. hartimi i mekanizmit dhe metodës së shpërndarjes, edhe pse paraqesin zgjidhje politike, megjithatë duhet të mbështeten në parime të shëndosha ekonomike.

Sistemi i decentralizmit fiskal në Republikën e Maqedonisë (RM) ka filluar të implementohet formalisht me nisjen e procesit të decentralizmit në vitin 2005. Sistemi i ri i financave lokale publike përpos objektivitetit, transparencës, stabilitetit dhe barabarësisë, detyrimisht duhet të sigurojë autonomi të komunave dhe të drejtë për menaxhim të politikave fiskale në kuadër të kompetencave të dhëna me Ligjin për vetëqeverisje lokale (2002). Në fakt, zhvillimi i vetëqeverisjes lokale më së shpeshti llogaritet sipas shkallës së pjesëmarrjes së shpenzimeve të komunave në shpenzimet e përgjithshme ose përmes pjesëmarrjes proporcionale të shpenzimit publik lokal në bruto prodhimet vendore. Në veçanti është me rëndësi të dihet përqindja e të ardhurave të përgjithshme të komunave nga burimet e veta, për shpenzimin e të cilave autoritetet lokale kanë të drejtë diskrecionale për vendimmarrje. Sa më e lartë që është pjesëmarrja e resurseve të veta në të ardhurat, aq më autonom dhe më i pavarur është pushteti lokal, për shkak se më pak varet nga transferimi i mjeteve nga pushteti qendror.

Nga ana tjetër me rritjen e shpenzimeve publike në nivel lokal, pavarësisht nëse janë fituar si mjete të transferuara nga pushteti qendror, (së paku) do të kontribuohet drejt pavarësisë më të madhe fiskale të pushteteve lokale.

Dhjetë vite pas fillimit formal të bartjes së kompetencave të reja të komunave, si dhe futjes së të gjitha komunave në të ashtuquajturën fazë të dytë të decentralizimit fiskal, që njëkohësisht nënkupton edhe rritje të autonomisë fiskale, prapë se prapë disa analistë, por edhe një numër i

madh i kryetarëve të komunave konsiderojnë se decentralizimi fiskal nuk i ka dhënë rezultatet e pritura dhe komunat ende janë të kufizuara në raport me mundësitë dhe të drejtat fiskale (dhe financiare).

Njohësit e financave lokale dhe decentralizimit fiskal në R.M., si dhe një pjesë e hulumtimeve të bëra në këtë sferë më së shpeshti konstatojnë se:

- a. të ardhurat e komunave, të cilat jepen nga pushteti qendror nuk janë të përcaktuara në pajtim me nevojat e kompetencave të decentralizuara, por jepen në mënyrë arbitrare;
- b. ekziston dallim i madh ndërmjet mundësive financiare të komunave, për këtë arsye nevojitet formulë e qartë për shpërndarje të mjeteve, e cila do t'i reflektojë dallimet mes komunave;
- c. siç ekziston dallimi ndërmjet komunave urbane dhe atyre rurale, njashtu ekziston dallim i madh ndërmjet mjediseve urbane dhe rurale të vetë komunave;
- d. grantet sektoriale, gjegjësisht bllok dotacionet dhe shpërndarja e tyre të bëhet në bazë të analizës gjithëpërfshirëse;
- e. varësia financiare nga pushteti qendror është shumë më e madhe, gjë që e kufizon autonominë e komunave;
- f. shkurtimi i fondeve të caktuara dhe dotacioneve është goditje e madhe për arkat e komunave dhe paraqet pengesë reale në përmbushjen e kompetencave të tyre;
- g. me të drejtën e lëshimit të obligacioneve, komunat fitojnë mekanizëm shtesë për huamarrje, por nuk fitojnë rritje të autonomisë fiskale, për shkak se ngjashëm me llojet tjera të huamarrjes nevojitet të kërkojnë dhe të marrin miratimin e qeverisë së R.M. - së, pasi të sigurojnë mendim pozitiv nga Ministria e Financave. (Hristov, Naumoski, & Vrteski, Financat lokale në Republikën e Maqedonisë 2013-2014, 2016)

Sipas Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale, **Ligji për zhvillimin e barabartë rajonal** ka të bëjë me rregullimin e qëllimeve, parimeve dhe bartësve të politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal; planifikimin e zhvillimit rajonal; financimin dhe ndarjen e mjeteve për nxitjen e zhvillimit

të barabartë rajonal; përcjelljen dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve dhe projekteve të planit si dhe çështjeve të tjera të lidhura me zhvillimin rajonal.

Në ligjin për zhvillimin e barabartë rajonal kemi të bëjmë me shprehje të veçanta të cilat janë pjesë e këtij ligji dhe kuptimi i tyre është siç vijon:

- a) **Zhvillimi rajonal është procesi i identifikimit**, nxitjes, menaxhimit dhe shfrytëzimit të potencialeve zhvillimore të rajoneve dhe vendeve të planit, me nevoja specifike zhvillimore;
- b) **Politika për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal** - është sistemi i qëllimeve, instrumenteve dhe masave të orientuara në zvogëlimin e pabarazive rajonale dhe realizimin e zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë.
- c) **Rajoni i planit është njësia funksionale-territoriale** e themeluar për nevojat e planifikimit të zhvillimit dhe për realizimin e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.
- d) **Planifikimi i zhvillimit rajonal** është procesi për përcaktimin e qëllimeve reale dhe koherente, prioriteteve dhe masave për nxitjen e zhvillimit.
- e) **Strategjia për zhvillimin rajonal të Republikës së Maqedonisë** është dokument plani afatgjatë, me të cilin përcaktohen principet, qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit rajonal në Republikën e Maqedonisë, masat, instrumentet dhe mjetet financiare e të tjera për realizimin e tyre.
- f) **Programi për zhvillimin e rajonit të planit** është dokument plani afatmesëm, ku përcaktohen qëllimet zhvillimore të rajonit të planit, masat, instrumentet dhe mjetet financiare e të tjera për realizimin e tyre.
- g) **Plani aksionar** është dokumenti operativ afatshkurtër, ku përcaktohen bartësit, mjetet financiare dhe dinamika kohore për realizimin e projekteve.
- h) **Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë** është trup për harmonizimin dhe koordinimin e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.
- i) **Këshilli për zhvillimin e rajonit të planit** është trupi për harmonizimin dhe zbatimin e politikës për zhvillimin planit rajonal.

Në këtë ligj përfshihen qëllimet dhe parimet e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal.

Qëllimet e politikës për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal janë:

- zhvillimi i barabartë dhe i qëndrueshëm në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë i bazuar në modelin e zhvillimit policentrik;
- zvogëlimi i pabarazive ndërmjet dhe në kuadër të rajoneve të planit, si dhe ngritja e kualitetit të jetës për të gjithë qytetarët;
- rritja e konkurrencës së rajoneve të planit nëpërmjet forcimit të kapacitetit të tyre të inovacionit, shfrytëzimi optimal dhe valorizimi i pasurisë natyrore, kapitalit njerëzor dhe veçorive ekonomike të rajoneve të ndryshme;
- ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të veçantë të rajoneve të planit si dhe afirmimi dhe zhvillimi i tyre;
- rivitalizimi i fshatrave dhe zhvillimi i rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe
- përkrahja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe tejkuftar të njësive të vet administrimit lokal në funksion të nxitjes së zhvillimit të barabartë rajonal.

6. Planifikimi i zhvillimit rajonal (Rajonet e planit)

Për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe realizimit të masave dhe instrumenteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal, caktohen rajonet e planit, ndërkaq për nevojat e planifikimit të zhvillimit rajonal dhe realizimit të masave dhe instrumenteve specifike për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal caktohen rajonet me nevoja specifike zhvillimore.

Rajonet me nevoja specifike zhvillimore janë: rajonet kufitare, rurale, kodrinore – malore dhe të tjera, që ngecin në zhvillim, pastaj rajonet me pasuri natyrore dhe trashëgimi kulturore të cilat janë të mbrojtura me ligj dhe së fundi rajonet e tjera me nevoja specifike zhvillimore të përcaktuara me ligj.

Rajoni me nevoja specifike zhvillimore mund të shtrihet në rajonin e një apo më tepër njësive të vetadministrimit lokal në kuadër të një apo më tepër rajoneve të planit.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miraton listën e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore me propozimin e Këshillit për zhvillim të harmonizuar regjional të Republikës së Maqedonisë. Lista e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore revidohet në çdo të pestin vit.

7. Financimi i zhvillimit rajonal (Burimet e financimit të zhvillimit rajonal)

Burimet e financimit të zhvillimit rajonal janë: buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e njësive të vetadministrimit lokal, fondet e Unionit Evropian, burime të tjera ndërkombëtare, donacionet dhe sponsorimet nga personat fizikë dhe juridikë, mjetet e tjera të përcaktuara me ligj. Për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë për çdo vit ndahen mjete në lartësi prej së paku 1% nga PBSH.

Për nxitjen e zhvillimit të rajonit të planit, njësitë e vetadministrimit lokal mund të shfrytëzojnë edhe mjete nga fondet e Unionit Evropian. Shfrytëzimi i mjeteve nga fondet e Unionit Evropian rregullohet me aktin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

8. Shpërndarja e mjeteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal

- 70% për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit;
- 20% për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore;
- 10% për financimin e projekteve për zhvillimin e fshatrave.

9. Ndarja e mjeteve për nxitjen e zhvillimit të barabartë rajonal

Pas vlerësimit të kryer të projekteve, Komisioni përgatit propozim-lista për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit, projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja

specifike zhvillimore dhe projekteve për zhvillimin e fshatrave. Propozim-listat përgatiten veç e veç për secilin rajon. Propozim-listat i dërgohen Këshillit për zhvillimin e barabartë rajonal.

Këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal, në bazë të propozim-listave e përcakton propozimin për financimin e projekteve konkrete për zhvillimin e rajoneve të planit, rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe fshatrave. Gjatë përcaktimit të propozimit për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit dhe zhvillimin e fshatrave, këshilli për zhvillimin e barabartë rajonal mban llogari për përfaqësimin e drejtë gjatë ndarjes së mjeteve të të gjitha komunave që bëjnë pjesë në rajonin e planit.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të propozimit nga ligji merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve të planit, rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe fshatrave.

Në bazë të Vendimit për ndarjen e mjeteve, Byroja për Zhvillimin Rajonal lidh marrëveshje për realizimin e projekteve. Marrëveshjet për realizimin e projekteve për zhvillimin e rajonit të planit lidhen me qendrat për zhvillimin e rajoneve të planit të cilat i realizojnë projektet në bashkëpunim me komunat me të cilat kanë të bëjnë.

Marrëveshjet për implementimin e projekteve për zhvillimin e rajoneve me nevoja specifike zhvillimore dhe zhvillimin e fshatrave lidhen me komunat që janë bartëse të projekteve. Mënyra dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare përcaktohen me marrëveshje.

Sa i përket pjesës së financimit të projekteve sipas regjioneve do të paraqesim një vendim për financimin e projekteve nga ana e Byrosë për Zhvillim Rajonal ku përfshihen rajoni i planifikuar i Pollogut, i Shkupit, rajoni i planifikuar juglindor, rajoni i planifikuar jugperendimor, rajoni i planifikuar i Vardarit e të tjerë.

LISTA E PROJEKTEVE PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE TË PLANIFIKUARA TË VITIT 2016²²

Rajoni i planifikuar i Shkupit					
Nr.	Emri i projektit	Shfrytëzues i mjeteve	Mjetet e ndara në denar		
			Gjithsej	Për projektin	Për menaxhim
1	Ndërtimi i instalimit elektrik në shpellën Vrella-kanjoni Matka	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar të Shkupit	2.863.222	2.574.652	288.570
2	Rikonstruimi e një pjese të rrugës kaluese deri te qendra rekreative Teferiç-faza 2	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar të Shkupit	6.092.404	5.180.974	911.430
3	Mjetet e përgjithshme		8.955.626	7.755.626	1.200.000
Rajoni i planifikuar juglindorë					
Nr. Rend.	Emri i projektit	Shfrytëzues i mjeteve	Mjetet e ndara në denar		
			Gjithsej	Për projektin	Për menaxhim
1	Ndërtimi i një pjese rruge mes vendbanimit Çanaklija dhe Nova Mahalla me gjatësi prej 1 km	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar juglindor	8.771.183	8.000.000	771.183
2	Ndërtimi i rrugës lokale që i lidh fshatin Mutrino Ednokuqevu me largësi prej 1387 metra –faza e dytë	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar juglindor	5.035.408	4.606.591	428817
	Mjetet e përgjithshme		13.806.591	12.606.591	1.200.000
Rajoni i planifikuar i Lindor					
Nr.r	Emri i projektit	Shfrytëzues i mjeteve	Mjetet e ndara në denar		
			Gjithsej	Për projektin	Për menaxhim
1	Ndërtimi i rajonal etno parku në fshatin Zrnovcë-faza 1	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar Lindorë	2.599.583	2.354.423	245.160
2	Rregullimin e koritës së lumit Vinikës	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar Lindorë	5.501.283	5.057.484	443.799
3	Ndërtimi pplakës përkujtimore i të rënave të Nikolla Karev “Svillanovo”	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar Lindorë	5.954.492	5.443.451	511.041

²² <http://brr.gov.mk/sq/projektet-aktual/>

Mjetet e përgjithshme			14.055.358	12.855.358	1.200.000
Rajoni i planifikuar i Pellagonisë					
Nr.r	Emri i projektit	Shfrytëzues i mjeteve	Mjetet e ndara në denar		
1	Rikonstruimi i tregut të gjelbërt regional në komunën e Demir Hisarit		Gjithsej	Për projektin	Për menaxhim
			6.488.996	6.000.047	488.949
2	Përmirësimin e ofertës kulturore regionale në drejtim të zhvillimit të turizmit-rregullimin e hapësirës për mbajtjen e ngjarjeve me interes kombëtar(Dollneni)	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuari Pellagonisë	1.947.696	1.800.000	147.696
3	Furnizimi i veturave të zjarrëfiksive për mrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe potencialeve mbiturizmin në rajonin e pellagonisë(Krushevë)		4415.176	4.000.003	415.173
4	Rregullimi i koritës së Crna Rekës dhe degzat elumit nga rrjedhja e lumit të komunës së Mogillas, Novaci;Demir Hisarit dhe Manastirit(faza e tretë)		1.948.155	1.799.973	148.182
Mjetet e përgjithshme			14.800.023	13.600.023	1.200.000
Rajoni i planifikuar i Pollogut					
Nr.	Emri i projektit	Shfrytëzues i mjeteve	Gjithsej	Për projekt	Për menaxhim
1	Rehabilitimi i rrugës lokale nga ura Sushki deri te deponoja Rusino komuna e Gostivarit	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar të Pollogut	1.122.787	1.088.500	34.287
	Mjetet e përgjithshme		1.122.787	1.088.500	34.287
Rajoni i planifikuar Jugperëndimor					
Nr.	Emri i projektit	Shfrytëzues i mjeteve	gjithsej	Mjetet e ndara në denarë	
				Për projektin	Për menaxhim
1	Përmirësimi i shërbimeve në mjediset turistiken NPSH	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar jugperëndimor	1.995	1.950.451	44.616

2	Realizimi i objekteve efikase energjetike	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar jugperëndimor	14..547.965	13.392.581	1.155.384
	Mjetet e përgjithshme		16.543.032	15.343.032	1.200.000
Rajoni i planifikuar i Vardarit					
Nr.	Emri i projektit	Shfrytëzues i mjeteve	Mjetet e ndara në denarë		
			gjithsej	Për projekte	Për menaxhim
1	Mbrojtja e ujrave të lumit Mlladost përmes rregullimit të ujrave të zeza të lagjes Otovica komuna e Velesit	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar i Vardarit	8.197.364	7.661.539	535.825
2	Përmirësimi i mjedisit jetësor përmes rregullimit të koritave të lumit të lumit Luda Mara komuna e Kavadarcit	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar i Vardarit	9.629.433	9.000.000	629.433
3	Ndërtimi i infrastrukturës komunale në fshatin të vjetër të verës Klisura.fsh.Klisura komuna e Demir Kapisë(ujësjellës faza e dytë)	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar i Vardarit	457.608	422.865	34.743
Mjetet e përgjithshme			26.359.384	25.159.384	1.200.000
Rajoni i planifikuar Verilindor					
1	Përmirësimi i kushteve për zhvillim rural, të turizmit dhe mobilizim në rajonin verilindor faza e dytë	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar Verilindor	18.448.7069	17.336.020	1.112686
2	Mbrojtjen e mjedisit jetësor	Qendra për zhvillim të rajonit të planifikuar Verilindor	3.069.674	2.982.360	87.314
	Mjetet e përgjithshme		21.518.380	20.318.380	1.200.000
Mjetet e përgjithshme për financimin e projekteve mbi zhvillimin e rajoneve planore-109.086.201 denar					

Nga tabela më lartë vërejmë se pjesët më të mëdha të financimit të projekteve janë në zonat ku ka më shumë popullatë maqedone. Ka një çrregullim sa i përket financimit sipas rajoneve. Më duhet të konstatoj, sa i përket zhvillimit rajonal në Maqedoni, se pjesët ku jetojnë shqiptarët ka shumë pak financime të projekteve, ndërsa te pjesa ku jetojnë maqedonasit ka më shumë. Këtu

flitet për një shpërndarje jo të drejtë të mjeteve. Thënë ndryshe pjesa apo vendbanimet ku jetojnë shqiptarë është e varfër dhe nuk bëhet asgjë me vite.

Maqedonia është vend me dy botëra të ndryshme: njëra pjesë është e zhvilluar, ndërsa pjesa tjetër nuk është aspak e zhvilluar. Kjo tregon se mënyra e financimit të rajoneve nuk është e drejtë.

Për të vënë kontroll në mënyrën dhe për çfarë shpenzohet 1% i PBV-së, para të caktuara për zhvillimin e barabartë të rajoneve, Qeveria me fondet Zvicerane do të zhvillojë softuer kompjuterik. Përmes softuerit do të ndiqet si shpenzohen fondet buxhetore për këtë qëllim. Mjetet buxhetore duhet të ndahen në përputhje me nivelin e zhvillimit të rajoneve. Përndryshe, pikërisht për shkak të zhvillimit të pabarabartë dhe mungesës së kushteve për jetesë cilësore, shumica e tetë rajoneve planore në vendin tonë u përballën me shpërngulje masive dhe rritje të numrit të fshatrave që mbeten pa banorë.²³

10. Perspektivat e decentralizimit fiskal

Përgjegjësia financiare është një komponent kyç i decentralizimit. Nëse pushtetet lokale dhe organizatat private kryejnë me efektivitet funksione të decentralizuara, ato duhet të kenë të ardhura të mjaftueshme - të realizuara lokalisht ose të transferuara nga pushteti qendror si dhe autoritetet për të marrë vendime mbi shpenzimet. Decentralizimi fiskal mund të marrë shumë forma që përfshijnë:

- A. vetë financim apo mbulim të kostove nëpërmjet të ardhurave nga përdoruesit;
- B. bashkë-financim apo bashkë-prodhim, ku përdoruesit marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve dhe infrastrukturës nëpërmjet kontributeve monetare dhe punës;

²³ Marrë nga Alsat - M, Zhvillimi i barabartë rajonal, jo funksional, <https://www.alsat-m.tv/zhvillimi-i-barabarte-rajonal-jofunksional/>, Qasje më: 18.12.2018.

- C. shtrirje të ardhurash lokale nëpërmjet taksave mbi pasurinë apo nga shitjet ose të ardhurat indirekte;
- D. transfertat ndërqeveritare të ardhurash të përgjithshme nga taksat e mbledhura nga pushteti qendror te pushteti lokal, për përdorim të përgjithshëm apo specifik;
- E. autorizim i marrjes hua nga bashkitë dhe mobilizim i burimeve kombëtare dhe të pushteteve lokale nëpërmjet garancive të huave.

Në shumë vende në zhvillim, pushtetet lokale apo njësite administrative kanë autoritetin ligjor të vendosin taksa, por baza e taksës është kaq e dobët dhe varësia të subvencionet e pushtetit qendror është aq e përcaktuar, saqë nuk bëhet asnjë përpjekje për të ushtruar këtë autoritet.

Në kushte të përshtatshme, të gjitha këto forma të decentralizimit mund të ndihmojnë në zgjerimin e pjesëmarrjes së publikut në veprimtaritë politike, ekonomike dhe shoqërore në vendet në zhvillim. Aty ku realizohet me efektivitet, decentralizimi ndihmon në lehtësimin e ngadalësisë në marrjen e vendimeve, që shkaktohet nga planifikimi i pushtetit qendror dhe kontrolli i veprimtarive të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore.

Decentralizimi mund të ndihmojë në thjeshtimin e procedurave komplekse burokratike dhe mund të rrisë sensibilitetin e zyrtarëve qeveritarë ndaj nevojave dhe kushteve lokale. Për më tepër, decentralizimi mund të ndihmojë ministritë e pushtetit qendror që të sigurojnë shërbime në një numër më të madh zonash lokale; që të lejojnë përfaqësi më të madhe politike të grupeve të ndryshme politike, etnike, fetare, qendrore, nga detyrat rutine, duke u dhënë mundësi atyre të përqendrohen më tepër në politikë. Decentralizimi mund të krijojë një fokus gjeografik në nivel lokal duke koordinuar më me efektivitet programet në nivel kombëtar, provincial, rajonal dhe lokal. Ai mund të sigurojë mundësi më të mira për banorët lokalë që të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve. Decentralizimi mund të çojë në programe të reja dhe të përgjegjshme duke lejuar eksperimentimin lokal.²⁴

²⁴ Marrë nga Insituti i Bankës Botërore, Decentralizimi, shënime përmbledhëse, 1999, Washington D.C.
<http://documents.worldbank.org/curated/en/356911468766815123/pdf/19683010albanian.pdf>

11. Ku është Republika e Maqedonisë në këtë proces?

Republika e Maqedonisë sa i përket procesit të zhvillimi të barabartë rajonal sipas mendimit tim nuk ka bërë hapa të rëndësishëm sa i përket pjesës me vendbanime shqiptare. Siç theksohet më lartë, ky stagnim në dimensionin ekonomik ka bërë që shumë fshatra dhe vende ku ka shumicë të popullatës shqiptare të mbeten me pak banorë.

Decentralizimi nuk ka kuptim nëse komunave u jepen vetëm kompetenca. Atyre duhet t'u jepet më tepër financim në rritjen e buxhetit në mënyrë që banorëve që jetojnë nëpër fshatra t'u mundësohen më tepër kushte për jetesë nga fakti që mos të vijë te shpërngulja nga fshati në qytet. Është mirë që të merret një model nga vendet apo shtetet e zhvilluara dhe të aplikohet edhe në Republikën e Maqedonisë. Kjo nënkupton decentralizim të fuqishëm dhe fazë të tretë të decentralizimit fiskal, zbatim të ligjit të 1% të Bruto Prodhimit Kombëtar, decentralizim të investimeve kapitale, dyfishim të buxhetit të komunave (me theks të veçantë të komunave me shumicë shqiptare).

Këtë vit është bërë një hap i rëndësishëm. Qeveria ka ndarë 57% më shumë mjete financiare për zhvillimin e barabartë rajonal apo 279,3 milionë denarë nga buxheti i Maqedonisë. 17 % do të ndahen për planet rajonale të cilët në numër janë tetë. Pra 195, 5 milionë denarë do të ndahen për 27 projekte, ndërsa 20% e mjeteve të përgjithëshme do të ndahen për projekte specifike për të cilët kanë shumë nevojë qytetarët e Maqedonisë, të financuar në forma të ndryshme dhe që janë mjaftë të rëndësishme për zhvillimin e barabartë rajonal.²⁵

Por kjo sipas mendimit tim, ndihmon pak në përmirësimin e kushteve dhe jetesës së popullatës shqiptare. Ky është problem shumëvjeçar që kërkon financim të drejtë dhe proporcional varësisht nga nevoja dhe nga kushtet se çfarë kërkohet në një vend të caktuar, duke pasur parasysh gjithmonë numrin e banorëve dhe kërkesat e tyre.

²⁵ Marrë nga <https://www.almakos.com/zhvillimi-i-barabarte-rajonal-qeveria-thote-se-ka-ndare-me-shume-mjete-video/>, Qasje më: 20.12.2018.

KAPITULLI IV – STUDIMI EMPIRIK (PËRSHKRIMI I TË DHËNAVE NGA TË ANKETUARIT)

1. Hyrje

Në këtë kapitull trajtojmë pjesën praktike të decentralizimit, kryesisht merret parasysh mendimi i qytetarëve në lidhje me decentralizimin. Si ndikoi decentralizimi në jetën e tyre, sa janë të kënaqur qytetarët me pushtetin qendror në aspektin e shpërndarjes së mjeteve të pushteti lokal. Gjithashtu trajtohen pyetje dhe përgjigje në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me ndikimet politike, aspektin ekonomik të decentralizimit si dhe mirëqenien e qytetarëve para dhe pas decentralizimit.

Hipotezat kryesore janë: procesi i decentralizimit ndikoi pozitivisht në marrëdhëniet më të mira politike dhe etnike në R.M.; procesi i decentralizimit fiskal përmirësoi mirëqenien ekonomike të qytetarëve. Hipotezat ndihmëse janë: të hyrat vetanake nuk mjaftojnë për të realizuar kompetencat dhe shërbimet publike lokale; komunat multietnike me anë të Komisioneve për Marrëdhënie në mes Komuniteteve kanë ngritur nivelin e kohezionit etnik dhe social në komunat; komunat që menaxhohen nga bashkësitë jo shumicë nuk kanë qasje të barabartë në investimet kapitale nga pushteti qendror.

2. Studimi empirik - Mendimi i qytetarëve (Përshkrimi i të dhënave)


Në këtë kapitull do të paraqitet pjesa praktike për studimin, pra analiza statistikore e rezultateve nga anketa e realizuar me qytetarët, e ndjekur nga struktura e hulumtimeve primare dhe e përfunduar me rezultatet nga të dhënat e mbledhura që përfshijnë analizat dhe vlerësimet se, sa qytetarët kanë njohuri për procesin e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë dhe sa ata janë të kënaqur me këtë proces, si ndikoi decentralizimi në jetën e tyre ekonomike dhe çfarë janë avantazhet që sjell decentralizimi në qoftë se zbatohet plotësisht. Të anketuarit janë përgjigjur në mënyrë të pavarur dhe pa ndikime nga të tjerët. Pyetjet që nuk kanë qenë të qarta, jam

angazhuar që t'u japë sqarim plotësues apo shtesë me të vetmin qëllim që i anketuari ta kuptojë esencën apo thelbin dhe kuptimin e vërtetë të pyetjes.

Më poshtë do të prezantojmë të dhënat empirike me figura, tabela dhe komente rreth të përgjigjeve të pranura nga qytetarët e grupmoshave të ndryshme mbi 18 vjet si dhe përgjigjet e tyre nga pyetësi i përpiluar me përqindje.


Prej 200 pyetësorëve të realizuar, siç mund të shihet në figurën 1, prej gjithsej të përgjigjurve 64% janë të gjinisë mashkullore ndërkaj 36% të gjinisë femërore.

Figura 1: Struktura gjinore e të anketuarve.



Siç mund të vërehet nga figura 1, në studimin e kryer kanë qenë të kyçur si persona të gjinisë mashkullore ashtu edhe të gjinisë femërore ndonëse ekzemplari përfshin një participim më të lartë të meshkujve (64%) krahasuar me femrat e anketuara (36%).

Figura 2: Struktura sipas përkatësisë etnike



Në studimin e kryer, në përputhshmëri me strukturën etnike të popullsisë në Republikën e Maqedonisë kanë qenë të kyçur persona të përkatësive të ndryshme etnike: shqiptarë, maqedonas dhe turq.

Siç mund të vërehet nga të dhënat e paraqitura në figurën 2, monstra është dominuar nga dy bashkësitë etnike më të mëdha në vend, pra nga shqiptarët që përbëjnë 82% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve dhe maqedonasit që participojnë me 13% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve. Në studim kanë qenë të përfshirë dhe 5% turq që gjithashtu përbëjnë numrin e përgjithshëm të të anketuarve.


Tabela 1: A ndikoi procesi i decentralizimit pozitivisht në marrëdhëniet politike dhe etnike në R.M.?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	33%	38%	41%	15%	22%	37%	21%	16%
Jo	67%	62%	59%	85%	78%	63%	79%	84%

Siç mund të vërehet nga të dhënat nga tabela 1, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve del se 33% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur me po, ndërsa 67% nga po e njëjta përkatësi

etnike janë përgjigjur me jo, 38% nga përkatësia etnike maqedonase janë përgjigjur me po, ndërsa 62% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike turke, 41% janë përgjigjur me po, ndërsa 59% janë përgjigjur me jo. Nga aspekti gjinor i të anketuarve, 15% të meshkujve janë përgjigjur me po, ndërsa 85% janë përgjigjur me jo. Nga femrat, 22% janë përgjigjur me po, ndërsa 78% janë përgjigjur me jo. Nga pikëpamja e grupmoshave, nga mosha (18-25), 37% e të anketuarve janë përgjigjur me jo, ndërsa 63% me po; nga mosha (25-40), 21% janë përgjigjur me po, ndërsa 79% janë përgjigjur me jo; nga mosha (mbi 40), 16% janë përgjigjur me po, ndërsa 84% me jo.

Figura 3: A keni dëgjuar për komisionin për marrëdhënie në mes komuniteteve në RM?




Sipas të anketuarve në figurën 3, 25% nga të anketuarit janë përgjigjur se kanë dëgjuar për komisionin për marrëdhënie në mes komuniteteve në R.M., ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve që përbëjnë 75% janë përgjigjur me jo, që do të thotë se nuk kanë dëgjuar për komisionin për marrëdhënie në mes komuniteteve apo bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

Tabela 2: A keni dëgjuar për komisionin për marrëdhënie në mes komuniteteve në RM?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	35%	24%	15%	23%	19%	14%	28%	38%
Jo	65%	76%	85%	77%	81%	86%	72%	62%

Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve, siç vërehet nga tabela 2, vërejmë se 35% nga të anketuarit nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur me po, ndërsa 65% me jo; nga përkatësia etnike maqedonase 24% janë përgjigjur me po, ndërsa 76% me jo; nga përkatësia etnike turke 15% janë përgjigjur me po, ndërsa 85% me jo. Sa i përket strukturës gjinore të të anketuarve 23% të meshkujve janë përgjigjur me po, ndërsa 77% me jo, nga struktura gjinore e femrave, 19% janë përgjigjur me po, ndërsa 81% me jo. Nga pikëpamja e grupmoshave; nga (18-25), 14% janë përgjigjur me po, ndërsa 86% me jo; nga (25-40), 28% janë përgjigjur me po, ndërsa 72% me jo; ndërsa nga mosha (mbi 40), 38% janë përgjigjur për po, ndërsa 62% janë përgjigjur me jo.

Figura 4: A mendoni se ka ndryshim në dimensionin politik të decentralizimit në R.M.?




Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve, nga figura 4, vërejmë se 15% e të anketuarve janë përgjigjur me po, në lidhje me ndryshimin e dimensionit politik të decentralizimit, 70% të të anketuarve janë përgjigjur me jo, ndërsa 15% nga të anketuarit nuk kanë njohuri në lidhje me këtë çështje.

Tabela 3: A mendoni se ka ndryshim në dimensionin politik të decentralizimit në R.M.?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	15%	22%	12%	24%	10%	29%	20%	16%
Jo	75%	77%	70%	66%	72%	38%	70%	72%
Nuk e di	10%	1%	18%	10%	18%	33%	10%	12%

Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve, siç vërehet nga tabela 3, vërejmë se 15% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur me po, 75% me jo, ndërsa 10% nga të anketuarit shqiptarë janë përgjigjur se nuk kanë njohuri në lidhje me këtë çështje. Nga përkatësia etnike maqedonase 22% janë përgjigjur me po, 77% me jo, ndërsa 1% nuk kanë njohuri në lidhje me këtë çështje. Nga përkatësia etnike turke janë përgjigjur me po - 12% e të anketuarve, me jo - 70%, ndërsa 18% nuk kanë pasur njohuri për këtë çështje. Sa i përket grupmoshave; nga (18-25), 29% janë përgjigjur me po, 38% me jo, ndërsa nuk kanë pasur njohuri 33% në lidhje me këtë çështje. Nga mosha (25-40), 20% janë përgjigjur me po, 70% me jo, ndërsa 10% nuk kanë pasur njohuri në lidhje me këtë çështje. Nga mosha (mbi 40), 16% janë përgjigjur me po, 72% me jo, ndërsa 12% nuk kanë pasur njohuri në lidhje me këtë çështje.

Figura 5: Sa jeni të kënaqur prej zbatimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit pas 17 viteve?




Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve siç e vërejmë në figurën 5, 65% e të anketuarve aspak nuk janë të kënaqur prej zbatimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, 20% janë përgjigjur se janë pak të kënaqur, 12% janë përgjigjur se janë mesatarisht të kënaqur, ndërsa vetëm 3% e të anketuarve janë përgjigjur se janë shumë të kënaqur.

Tabela 4: Sa jeni të kënaqur prej zbatimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit pas 17 viteve?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshku	Femra	Moshë 18-25	25-40	Mbi 40
Aspak të kënaqur	61%	52%	60%	65%	42%	61%	62%	68%
Pak të kënaqur	34%	35%	36%	25%	39%	30%	32%	21%
Të kënaqur	2%	10%	10 %	9%	15%	5%	4%	10%
Shumë të kënaqur	3%	3%	4%	1%	4%	4%	2%	1%

Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve siç vërehet nga tabela 4, 61% nga përkatësia etnike shqiptare aspak nuk janë të kënaqur prej zbatimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, 34% janë përgjigjur se janë pak të kënaqur, 2% janë përgjigjur se janë mesatarisht të kënaqur, ndërsa shumë të kënaqur janë vetëm 3%. Nga përkatësia etnike maqedonase, 52% janë përgjigjur se aspak nuk janë të kënaqur, 35% janë përgjigjur se janë pak të kënaqur, 10% janë përgjigjur se janë mesatarisht të kënaqur, ndërsa shumë të kënaqur janë përgjigjur vetëm 3%. Nga përkatësia etnike turke, aspak të kënaqur janë përgjigjur 60%, pak të kënaqur 36%, mesatarisht të kënaqur 10%, ndërsa shumë të kënaqur 4%. Sa i përket strukturës gjinore të të anketuarve nga gjinia mashkullore, 65% nuk janë aspak të kënaqur, 25% janë përgjigjur se janë pak të kënaqur, 9% janë përgjigjur se janë mesatarisht të kënaqur, ndërsa vetëm 1% janë përgjigjur se janë shumë të kënaqur. Nga gjinia femërore e të anketuarve, 42% nuk janë aspak të kënaqur, 39% janë përgjigjur si pak të kënaqur, 15% të kënaqur, ndërsa 4% shumë të kënaqur. Nga pikëpamja e moshës; nga (18-25), 61% nuk janë aspak të kënaqur, 30% janë përgjigjur se janë pak të kënaqur, 5% mesatarisht të kënaqur dhe vetëm 4% shumë të kënaqur. Nga mosha (25-40) e të anketuarve, 62% janë përgjigjur se nuk janë aspak të kënaqur, 32% pak të kënaqur, 4% mesatarisht të kënaqur dhe vetëm 2% shumë të kënaqur. Nga mosha (mbi 40) e të anketuarve, 68% janë përgjigjur se nuk janë aspak të kënaqur, 21% janë pak të kënaqur, 10% janë mesatarisht të kënaqur, ndërsa vetëm 1 % janë shumë të kënaqur.

Figura 6: A mendoni se të hyrat personale mjaftojnë për të realizuar kompetencat dhe shërbimet publike lokale?



Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve siç vërehet nga figura 6, në lidhje se a mjaftojnë të hyrat personale për të realizuar kompetencat dhe shërbimet publike komunale, 68% nga të anketuarit janë përgjigjur se nuk mjaftojnë, ndërsa 32% janë përgjigjur se mjaftojnë.


Tabela 5: A mendoni se të hyrat personale mjaftojnë për të realizuar kompetencat dhe shërbimet publike lokale?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Moshë 18-25	25-40	Mbi 40
Mjaftojnë	31%	28%	35%	34%	27%	35%	22%	32%
Nuk mjaftojnë	69%	72%	65%	66%	73%	65%	78%	68%

Siç mund të vërehet nga të dhënat në tabelën 5, nga numri i të anketuarve nga përkatësia etnike shqiptare, 31% janë përgjigjur se të hyrat personale mjaftojnë për të realizuar kompetencat dhe shërbimet publike lokale, ndërsa 69% janë përgjigjur se nuk mjaftojnë. Nga përkatësia etnike maqedonase 28% janë përgjigjur se mjaftojnë, ndërsa 72% nga të anketuarit janë përgjigjur se nuk mjaftojnë. Nga përkatësia etnike turke 35% janë përgjigjur se mjaftojnë, ndërsa 65% janë përgjigjur se nuk mjaftojnë. Nga struktura gjinore, prej meshkujve 34% janë përgjigjur se

mjaftojnë, ndërsa 66% janë përgjigjur se nuk mjaftojnë. Prej gjinisë femërore 27% janë përgjigjur se mjaftojnë, ndërsa 73% janë përgjigjur se nuk mjaftojnë. Nga pikëpamja e moshës; nga (18-25), 35% janë përgjigjur se mjaftojnë, ndërkaq 65% janë përgjigjur se nuk mjaftojnë. Nga mosha (25-40), 22% e të anketuarve janë përgjigjur se mjaftojnë, ndërsa 78% janë përgjigjur se nuk mjaftojnë. Nga mosha (mbi 40), 32% janë përgjigjur se mjaftojnë, ndërsa 68% janë përgjigjur se nuk mjaftojnë.

Figura 7: Sa ndikoi procesi i decentralizimit fiskal në R.M.?




Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve siç vërehet nga figura 7, nga të dhënat në lidhje me atë se sa ndikoi procesi i decentralizimit fiskal në R.M., 65% janë përgjigjur se nuk ka ndikuar aspak, 23% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërkaq 12% janë përgjigjur se shumë ka ndikuar.

Tabela 6: Sa ndikoi procesi i decentralizimit fiskal në R.M.?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Aspak	62%	58%	52%	64%	56%	49%	59%	67%
Pak	25%	31%	28%	31%	27%	38%	28%	27%
Shumë	13%	11%	20%	5%	17%	13%	13%	6%

Sipas të dhënave nga të anketuarit siç mund të shihet në tabelën 6, në lidhje me atë se sa ndikoi procesi i decentralizimit fiskal në R.M., nga përkatësia etnike shqiptare 62% janë përgjigjur se nuk ka ndikuar aspak, 25% janë përgjigjur se ka ndikuar pak, ndërsa 13% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë. Nga përkatësia etnike maqedonase 58% janë përgjigjur se nuk ka ndikuar aspak, 31% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërkaq vetëm 11% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë. Nga përkatësia etnike turke 52% janë përgjigjur se aspak nuk ka ndikuar, 28% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërsa 20% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë. Nga struktura gjinore e të anketuarve meshkuj, 64% janë përgjigjur se aspak nuk ka ndikuar, 31% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërsa 5% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë. Prej gjinisë femërore, 56% janë përgjigjur se aspak nuk ka ndikuar, 27% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërsa 17% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë. Nga pikëpamja e grupmoshave; prej (18-25), 49% janë përgjigjur se aspak nuk ka ndikuar, 38% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërsa 13% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë. Nga mosha (25-40), 59% janë përgjigjur se aspak nuk ka ndikuar, 28% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërsa 13% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë. Prej moshës (mbi 40), 67% janë përgjigjur se aspak nuk ka ndikuar, 27% janë përgjigjur se pak ka ndikuar, ndërsa 6% janë përgjigjur se ka ndikuar shumë.

Figura 8: A e përmirësoi procesi i decentralizimit mirëqenien ekonomike të qytetarëve?



Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve siç mund të vërehet në figurën 8, në lidhje me atë se a e përmirësoi procesi i decentralizimit mirëqenien ekonomike të qytetarëve, 52% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 10% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 38% janë përgjigjur se nuk shohin ndonjë ndryshim në lidhje me këtë çështje.


Tabela 7: A e përmirësoi procesi i decentralizimit mirëqenien ekonomike të qytetarëve?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	mbi 40
jetoj më keq se para decentralizimit	51%	45%	49%	58%	45%	48%	54%	60%
Jetoj më mirë se para decentralizimit	20%	15%	12%	5%	19%	20%	5%	8%
Nuk ka ndry.	29%	40%	39%	37%	37%	32%	41%	32%

Sipas numrit të të anketuarve siç vërehet nga tabela 7, nga numri i të dhënave del se 51% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 20% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 29% janë përgjigjur se nuk shohin ndryshim deri më tani. Nga përkatësia etnike maqedonase, 45% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 15% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 40% janë përgjigjur se nuk ka ndryshim. Nga përkatësia etnike turke, 49% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 12% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 39% janë përgjigjur se nuk ka ndryshim sa i përket kësaj çështjeje.

Nga struktura gjinore, prej meshkujve, 58% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 5% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 37% janë përgjigjur se nuk ka ndryshim. Nga gjinia femërore, 45% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 19% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 37% janë përgjigjur se nuk ka ndryshim. Sa i përket grupmoshave; nga mosha (18-25), 48% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 20% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 32% janë përgjigjur se nuk ka ndryshim. Nga mosha (25-40), 54% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 5% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para procesit të decentralizimit, ndërsa 41% janë përgjigjur se nuk ka ndryshim. Nga mosha (mbi 40), 60% janë përgjigjur se jetojnë më keq se para decentralizimit, 8% janë përgjigjur se jetojnë më mirë se para decentralizimit, ndërsa 32% janë përgjigjur se nuk shohin ndryshim, respektivisht janë përgjigjur se nuk ka ndryshim.

Figura 9: A mendoni se decentralizimi fiskal krijoi perspektiva të reja në R.M.?



Sipas numrit të përgjithshëm të të anketuarve siç vërehet nga figura 9, në lidhje me atë se a krijoi decentralizimi fiskal perspektiva të reja në R.M., del se 27% të të anketuarve janë përgjigjur me po, ndërsa shumica që përbëjnë 73% janë përgjigjur me jo.


Tabela 8: A mendoni se decentralizimi fiskal krijoi perspektiva të reja në R.M.?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	22%	30%	35%	28%	24%	31%	26%	27%
Jo	78%	70%	65%	72%	76%	69%	74%	73%

Nga tabela 8, nga të dhënat vërejmë se, nga përkatësia etnike shqiptare 22% janë përgjigjur se decentralizimi fiskal krijoi perspektiva të reja, ndërsa 78% janë përgjigjur se decentralizimi fiskal nuk krijoi perspektiva të reja në R.M. Nga përkatësia etnike maqedonase, 30% janë përgjigjur me po, ndërsa 70% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike turke 35% janë përgjigjur me po, ndërsa 65% me jo. Nga struktura gjinore e të anketuarve del se prej meshkujve, 28% janë përgjigjur me po, ndërsa 72% me jo. Nga gjinia femërore del se 24% janë përgjigjur me po,

ndërkaq 76% janë përgjigjur me jo. Nga pikëpamja e grupmoshave; nga mosha (18-25), 31% janë përgjigjur me po, ndërsa 69% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (25-40), 26% janë përgjigjur me po, ndërsa 74% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (mbi 40), 27% janë përgjigjur me po, ndërsa 73% janë përgjigjur se decentralizimi fiskal nuk krijoi perspektiva të reja në Republikën e Maqedonisë.

Figura 10: A mendoni se pushteti lokal ballafaqohet me mungesë të mjeteve nga pushteti qendrorë?




Sipas figurës 10, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve vërejmë se 71% janë përgjigjur se pushteti lokal ballafaqohet me mungesë të mjeteve nga pushteti qendror, 20% janë përgjigjur me jo, ndërsa 9% janë përgjigjur se nuk shohin ndonjë ndryshim në lidhje me këtë çështje.

Tabela 9: A mendoni se pushteti lokal ballafaqohet me mungesë të mjeteve nga pushteti qendrorë?

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	78%	54%	62%	74%	66%	70%	75%	80%
Jo	15%	30%	31%	16%	30%	21%	20%	16%
Nuk e di	7%	16%	7%	10%	4%	9%	5%	4%

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 9, vërejmë se 78% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur me po, 15% me jo dhe 7% janë përgjigjur se nuk kanë njohuri. Nga përkatësia etnike maqedonase, 54% janë përgjigjur me po, 30% janë përgjigjur me jo, ndërsa 16% janë përgjigjur se nuk kanë njohuri. Nga përkatësia etnike turke, 62% janë përgjigjur me po, 31% janë përgjigjur me jo, ndërsa 7% janë përgjigjur se nuk kanë njohuri. Nga struktura gjinore e të anketuarve nga gjinia mashkullore, 74% janë përgjigjur me po, 16% janë përgjigjur me jo dhe 10% janë përgjigjur se nuk e dinë. Nga gjinia femërore, 66% janë përgjigjur me po, 30% janë përgjigjur me jo, ndërsa 4% janë përgjigjur se nuk e dinë. Sa i përket grupmoshave, të dhënat tregojnë se, nga mosha (18-25), 70% janë përgjigjur me po, 21% janë përgjigjur me jo dhe 9% janë përgjigjur se nuk e dinë. Nga mosha (25-40), 75% janë përgjigjur me po, 20% janë përgjigjur me jo, ndërsa 5% janë përgjigjur se nuk e dinë. Nga mosha (mbi 40), 80% janë përgjigjur se pushteti lokal ballafaqohet me mungesë të mjeteve nga ai qendror, 16% janë përgjigjur me jo, ndërsa 4% janë përgjigjur se nuk kanë njohuri rreth kësaj çështjeje.

Figura 11: Në komunën time investohet rregullisht në mirëmbajtjen e rrugëve lokale



Siç mund të vërehet nga figura 11, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve del se 67% janë përgjigjur me jo, se në komunën time nuk investohet rregullisht në mirëmbajtjen e rrugëve lokale, ndërsa 33% janë përgjigjur me po.


Tabela 10: Në komunën time investohet rregullisht në mirëmbajtjen e rrugëve lokale

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	32%	45%	36%	31%	38%	34%	22%	28%
Jo	68%	55%	64%	69%	62%	66%	78%	72%

Siç mund të vërehet nga tabela 10, nga të dhënat e paraqitura del se, 32% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur me po, ndërsa 68% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike maqedonase 45% janë përgjigjur me po, ndërsa 55% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike turke 36% janë përgjigjur me po, ndërsa 64% janë përgjigjur me jo. Nga struktura gjinore, prej gjinisë mashkullore, 31% janë përgjigjur me po, ndërsa 69% janë përgjigjur me jo. Nga gjinia femërore, 38% janë përgjigjur me po, ndërsa 62% janë përgjigjur me jo. Nga grupmoshat; nga

mosha (18-25), 34% janë përgjigjur me po, ndërsa 66% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (25-40), 22% janë përgjigjur me po, ndërsa 78% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (mbi 40), 28% janë përgjigjur me po, ndërsa 72% janë përgjigjur se në komunë nuk investohet rregullisht në mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

Figura 12: Në komunën time investohet rregullisht në objektet arsimore



Sipas figurës 12, vërejmë se nga të anketuarit, 71% janë përgjigjur se në komunën time nuk investohet rregullisht në objektet arsimore dhe 29% janë përgjigjur se investohet rregullisht në objektet arsimore.


Tabela 11: Në komunën time investohet rregullisht në objektet arsimore

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	25%	34%	28%	26%	31%	34%	29%	27%
Jo	75%	66%	72%	74%	69%	66%	71%	73%

Sic mund të vërehet nga tabela 11, nga të dhënat e paraqitura del se, 25% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur me po, ndërsa 75% me jo. Nga përkatësia etnike maqedonase vërehet

se 34% janë përgjigjur me po, ndërsa 66% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike turke, 28% janë përgjigjur me po, ndërsa 72% janë përgjigjur me jo. Nga struktura gjinore, prej gjinisë mashkullore, 26% janë përgjigjur me po, ndërsa 74% janë përgjigjur me jo. Nga gjinia femërore 31% janë përgjigjur me po, ndërsa 69% janë përgjigjur me jo. Sa i përket grupmoshave, nga mosha (18-25), 34% janë përgjigjur me po, ndërsa 66% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (25-40), 29% janë përgjigjur me po, ndërsa 71% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (mbi 40), 27% janë përgjigjur se komuna investon rregullisht në objekte arsimore, ndërsa 73% janë përgjigjur se komuna nuk investon rregullisht në objekte arsimore.

Figura 13: Në komunën time investohet në objekte në sferën e mbrojtjes sociale




Siç mund të vërehet nga figura 13, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve del se 62% janë përgjigjur se komuna nuk investon rregullisht në objekte në sferën e mbrojtjes sociale, ndërsa 38% janë përgjigjur se komuna investon në objekte në sferën e mbrojtjes sociale.

Tabela 12: Në komunën time investohet në objekte në sferën e mbrojtjes sociale

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	35%	39%	36%	38%	42%	35%	34%	22%
Jo	65%	61%	64%	62%	58%	65%	66%	78%

Siç mund të vërehet nga tabela 12, nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërejmë se, 35% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur se komuna investon në objekte në sferën e mbrojtjes sociale, ndërsa nga po e njëjta përkatësi etnike rezulton që 65% janë përgjigjur se komuna nuk investon në objekte në sferën e mbrojtjes sociale. Nga përkatësia etnike maqedonase, 39% janë përgjigjur me po, ndërsa 61% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike turke 36% janë përgjigjur me po, ndërsa 64% janë përgjigjur me jo. Nga struktura gjinore; prej meshkujve 38% janë përgjigjur me po, ndërsa 62% janë përgjigjur me jo. Nga gjinia femërore, 42% janë përgjigjur me po, ndërsa 58% janë përgjigjur me jo. Nga grupmoshat; nga mosha (18-25), 35% janë përgjigjur me po, ndërsa 65% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (25-40), 34% janë përgjigjur me po, ndërsa 66% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (mbi 40), 22% janë përgjigjur me po, ndërsa 78% janë përgjigjur me jo.

Figura 14: Në komunën time është krijuar ambient ekonomik për investime




Siç mund të vërehet nga figura 14, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve vërejmë se 64% janë përgjigjur se në komunën time nuk është krijuar ambient ekonomik për investime, ndërsa 36% janë përgjigjur se është krijuar ambient ekonomik për investime.

Tabela 13: Në komunën time është krijuar ambient ekonomik për investime

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	34%	48%	35%	25%	36%	33%	39%	24%
Jo	66%	52%	65%	75%	64%	67%	61%	76%

Siç mund të vërehet nga tabela 13, nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërejmë se, 34% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur që në komunën time është krijuar ambient ekonomik për investime, ndërsa nga po e njëjta përkatësi etnike rezulton që 66% janë përgjigjur se në komunë nuk është krijuar ambient ekonomik për investime. Nga përkatësia etnike maqedonase, 39% janë përgjigjur me po, ndërsa 61% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike turke 48% janë përgjigjur me po, ndërsa 52% janë përgjigjur me jo. Nga struktura gjinore; prej meshkujve 25% janë përgjigjur me po, ndërsa 75% janë përgjigjur me jo. Nga gjinia femërore, 36% janë përgjigjur me po, ndërsa 64% janë përgjigjur me jo. Nga grupmoshat; nga mosha (18-25), 33% janë përgjigjur me po, ndërsa 67% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (25-40), 39% janë përgjigjur me po, ndërsa 61% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (mbi 40), 24% janë përgjigjur me po, ndërsa 76% janë përgjigjur me jo.

Figura 15: Në komunën time ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokalë



Siç mund të shihet nga figura 15, nga numri i përgjithshëm i të anketuarve vërejmë se 66% janë përgjigjur se në komunën time nuk ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokalë, ndërsa 34% janë përgjigjur se në komunën time ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokalë.

Tabela 14: Në komunën time ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokal

	Shqiptar	Maqedonas	Turq	Meshkuj	Femra	Mosha 18-25	25-40	Mbi 40
Po	32%	43%	40%	33%	38%	37%	29%	25%
Jo	68%	57%	60%	67%	62%	63%	71%	75%

Siç mund të vërehet nga tabela 14, të dhënat e paraqitura në tabelë, vërejmë se, 32% nga përkatësia etnike shqiptare janë përgjigjur se në komunën time ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokalë, ndërsa nga po e njëjta përkatësi etnike rezulton që 66% janë përgjigjur se në komunë nuk ka subvencione dhe mbështetje për afaristët lokalë. Nga përkatësia etnike maqedonase, 43% janë përgjigjur me po, ndërsa 57% janë përgjigjur me jo. Nga përkatësia etnike turke 40% janë përgjigjur me po, ndërsa 60% janë përgjigjur me jo. Nga struktura gjinore, prej meshkujve 33% janë përgjigjur me po, ndërsa 67% janë përgjigjur me jo. Nga gjinia femërore,

38% janë përgjigjur me po, ndërsa 62% janë përgjigjur me jo. Nga grupmoshat; nga mosha (18-25), 37% janë përgjigjur me po, ndërsa 63% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (25-40), 29% janë përgjigjur me po, ndërsa 71% janë përgjigjur me jo. Nga mosha (mbi 40), 25% janë përgjigjur me po, ndërsa 75% janë përgjigjur me jo.

3. Konkluzion

Nga ky studim empirik i realizuar me qytetarë të grupmoshave madhore të ndryshme, arrij të konstatoj se popullata në R.M. nuk është e kënaqur me realizimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, se nuk është zbatuar plotësisht ajo që është dashur të implementohet sipas marrëveshjes deri më vitin 2004. Qytetarët nuk janë të kënaqur nga niveli lokal, nga fakti se niveli lokal ka mungesë të mjeteve nga pushteti qendror dhe nuk mund t'i realizojë kërkesat dhe aktivitetet e qytetarëve për zhvillim të ndonjë projekti kapital. Pa decentralizim nuk mund të ketë institucione lokale efikase dhe efektive. Decentralizimi është një nga faktorët e rëndësishëm politik dhe ekonomik për përparim të nivelit lokal në të gjitha sferat. Decentralizimi fiskal shumë pak krijoi perspektiva të reja në Republikën e Maqedonisë. Komunat ballafaqohen me mungesë të mjeteve. Nuk investohet në objekte arsimore, rrugë etj., si dhe nuk ka mbështetje të plotë për investime kuptimplote. Pra, pa decentralizim do të vazhdohet të ketë ngarkesë në nivelin komunal dhe nuk do ketë rezultate pozitive për të mirën e qytetarëve, poashtu do të ketë shpërndarje jo të drejtë dhe të pabarabartë të mjeteve nga pushteti qendror.

4. Përfundime dhe rekomandime

Procesi i decentralizimit luan një rol të rëndësishëm në funksionimin e një shteti. Pa decentralizim nuk mundet që niveli lokal t'i përmbushë kërkesat e qytetarëve. Aspekti politik i decentralizimit dhe ai ekonomik janë shtyllat kryesore për avancim efikas të nivelit lokal në të gjitha sferat. Komunat si institucione nuk mundën t'i plotësojnë nevojat e qytetarëve për shkak të borxheve që ata thithin nga pushteti qendror si dhe nga fondet e huaja. Në mungesë të shlyerjes së borxhit, komunave nuk u mundësohet të marrin borxhe të reja. Qeveria e R.M. me shlyerjen e gjysmës së

borxhit ndihmoi që sado pak komunat apo niveli lokal të rimëkëmbet dhe të fillojë faza e zhvillimit kapital si dhe faza e përparimit në plotësimin e kërkesave që parashtrohen nga qytetarët.

Hulumtimi sjell në pah se komunat kanë mungesë kapaciteti të absorbojnë kompetencat e reja me procesin e decentralizimit. Kapaciteti i pamjaftueshëm i NJVL- është rezultat i kornizës së vendosur sistimore për zbatimin e procesit të decentralizimit në vend, që karakterizohet me decentralizimin simetrik të kompetencave në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimin asimetrik të burimeve në një numër të caktuar të njësive të vetëqeverisjes lokale. Ky model i decentralizimit shkakton probleme në disa NJVL për të absorbuar kompetenca të përcaktuara në nenin 22 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Mekanizmat sistimore të rregullimeve fiskale në mënyrë jo adekuate e zgjedhin problemin e asimetrisë së resurseve në NJVL.

Modeli ekzistues i granteve gjeneron pabarazi mes NJVL – si p.sh. në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm, në sferën e mbrojtjes sociale. Financimi i infrastrukturës dhe jo kompetencave, rezulton me përjashtimin nga shërbimet të grupeve më të rrezikuara të shoqërisë të cilat janë të vendosura kryesisht në komunat rurale. Pamjaftueshmëria e fondeve në arsim sjell vështirësi gjatë zbatimit të procesit arsimor nëpër shkolla në disa NJVL. Transferimi i shpërndarjes së taksave të përgjithshme (TVSH) me elemente të barazimit dhe bllok – dotacioneve për financimin e shërbimeve bazë nuk i përmbahet plotësisht parimit të qëndrueshmërisë dhe barazisë nga ana e qeverisë. Nga ana tjetër, sistemi ekzistues i taksave dhe tatimeve vendore është i tillë pasi që komunat rurale kanë kapacitet të ulët për grumbullimin e tatimeve, situatë që krijon varësi të përhershme nga dotacionet e pushtetit qendror për financimin e shërbimeve.

$\frac{3}{4}$ e buxhetit të NJVL-ve vjen nga grantet, grantet kapitale jo-tatimore dhe grantet e pakushtëzuara nga TVSH-ja dhe TAP-i, që flet për nevojën e analizës së vazhdueshme të këtyre dotacioneve dhe efektin e tyre në reduktimin e pabarazive mes NJVL-ve. Ky argument është i mbështetur nga raportet e Komisionit Evropian për progres të RM-së, të cilat tregojnë nevojën e përpjekjeve të mëtejshme në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të komunave në mënyrë që ato të mund t'i ushtrojnë kompetencat që u janë dhënë.

Ndarja e 1% të BPV-së për mbështetjen e zhvillimit të barabartë rajonal është një detyrim i caktuar me ligj. Në vitet e fundit ka tendenca të rritjes së mjeteve që shpërndahen nga Buxheti përmes MPL-së dhe Byrosë për Zhvillim Rajonal, por akoma ngelin nën nivelin e 1%-shit të BPV-së. Edhe pse Qeveria me Konkluzion ka vendosur që indeksi i zhvillimit rajonal për periudhën 2013-2017 duhet të merret parasysh në planifikimin dhe realizimin e granteve kapitale (rrugëve) dhe programeve të investimeve (çdo gjëje tjetër), nuk ka të dhëna në bazë të të cilave mund të vlerësojmë se sa nga këto mjete janë ndarë për rajonet/komunat e pazhvilluara.

Kjo situatë është potencuar në raportin e progresit të KE-së për RM-së, i cili sugjeron se është i nevojshëm kanalizimi i dispozitave të buxhetit qendror, siç është e përcaktuar me Ligjin për Zhvillim të Barabartë Rajonal, që deri më tani nuk janë zbatuar plotësisht.

Nuk është plotësisht e qartë se në bazë të cilave qëllime strategjike, prioriteteve dhe kriterëve është bërë përzgjedhja e projekteve që janë financuar nga grantet kapitale. Përveç kësaj, nuk ka të dhëna se si palët e interesuara, si p.sh. NJVL-ja dhe BNJVL-ja janë të përfshira në procedurat për përzgjedhjen dhe shpërndarjen e mjeteve nga ministritë dhe agjencitë përkatëse. Një konfirmim i këtij argumenti është raporti i progresit i KE për RM-së i cili potencon që investimet kapitale për projektet e realizuara nga ana e ministrive duhet të jenë më transparente.

Rekomandime

Duhet modifikuar transferimet ndërqeveritare për të zvogëluar pabarazinë ndërmjet NJVL-ve. Me qëllim të zmadhimit të kapaciteteve financiare të NJVL-ve është e nevojshme të merret në konsideratë rritja e pjesëmarrjes së granteve të pakushtëzuara në formën e TVSH-së dhe TAP-it. Grantet kapitale nga ministritë dhe agjencitë nuk favorizohen në bazë të kriterëve objektive (me përjashtim të zhvillimit rajonal), por janë objekt i një vendimi diskriminues, qasje që mund ta dëmtojë besueshmërinë për shpërndarje të drejtë dhe objektive të granteve kapitale.

Për të përmirësuar situatën e tillë dhe për të mundësuar komunat që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë kualitative, por që të jenë në funksion të zhvillimit, është e domosdoshme që shpenzimet totale të komunave në nivel kombëtar në pesë vitet e ardhshme të arrijnë deri në 14% të BPV-së ose rreth 27% të totalit të shpenzimeve në nivel kombëtar, që është mesatarja e vendeve të OBEZH-it, por edhe mesatarja evropiane për nivelin më të ulët të qeverisjes. Për t'u arritur ky nivel, është e domosdoshme që të miratohet një strategji për përmirësimin e kapaciteteve të komunave, përmirësimin e transparencës si dhe zhvillimin e mekanizmave të kontrollit. Ky nivel duhet të arrihet edhe me rritjen dhe përmirësimin e burimeve vetanake të financimit.

Pabarazitë fiskale ndërmjet komunave rurale dhe urbane implikojnë nevojën e mekanizmave fiskale për adresimin e pabarazive ndërmjet komunave, d.m.th. për barazim fiskal, i cili do t'i neutralizonte çrregullimet ekonomike që kanë rezultuar nga dallimet e kapaciteteve fiskale të komunave. Kjo do t'u mundësonte atyre të kenë burimet e nevojshme për ofrimin efektiv të shërbimeve ndaj qytetarëve. Duhet të krijohen dy mekanizma: një fond solidar i komunave dhe një i pushtetit qendror. Fondi solidar i komunës do të krijohet duke ua shpërndarë komunave rurale 100% pjesën e TAP-it, por komunat urbane dhe komunat e pasura duhet që 70% të këtyre burimeve t'i transferojnë në fondin e barazimit i cili më pas do t'ua shpërndajë sipas kriterëve komunave që kanë nevojë për atë. Pushteti qendror duhet të shpërndajë 2% të TVSH-së për barazimin horizontal dhe vertikal në mes të komunave.

Në lidhje me grantet kapitale dhe programet e investimeve, programet ekzistuese të investimeve duhet të transformohen në grante kapitale bazuar në një formulë objektive të shpërndarjes. Një nga kriteret duhet të jetë kapaciteti mesatar i komunës për mbledhjen e të ardhurave lokale (baza mesatare tatimore) kurse komunat me kapacitet nën mesataren (me bazë të ulët të tatimeve, me numër më të vogël të banorëve apo me aktivitet më të ulët ekonomik) duhet të bëjnë përpjekje fiskale për të marrë më shumë burime dhe investime. Pra, këto komuna duhet të kenë përparësi ndaj komunave me kapacitet mbi-mesatar për mbledhjen e të hyrave (bazë më të fortë të tatimeve). Duhet gjithashtu të bëhet transformimi i investimeve kapitale në grante kapitale

me një faktor të barazimit për NJVL-në, në mënyrë që çdo NJVL të ketë mjete financiare për rindërtimin ose përmirësimin e objekteve ekzistuese në fushat përkatëse ose për ndërtimin e objekteve të reja në përputhje me nevojat e tyre specifike dhe prioritare.

Duhet të rritet përqindja e TVSH-së me qëllim të përmirësimit të autonomisë fiskale të komunave, që njëkohësisht do të mundësojë funksionimin efektiv të komunave dhe ushtrimin e kompetencave të tyre në përputhje me procesin e decentralizimit. Kjo do të kontribuojë gjithashtu në krijimin e një fondi komunal të barazimit i cili do të reduktojë pabarazitë në të ardhurat për kokë banori midis komunave.

Një rekomandim i vlefshëm është edhe fuqizimi i bashkësive lokale për ta fituar statusin e personit juridik duke e avancuar inkuadrimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e vendimmarrjes.

Bibliografia

Literatura e shfrytëzuar

(ZELS), A. i. *Decentralizimi në Maqedoni*. Basse Normandie Macedoine.

Ahmad, J., & Blair, H. (1999). *Decentralizimi- Shënime përmbledhëse*. Washington, D.C: Instituti i Bankës Botërore.

Ahmad, J., Blair, H., Esmail, T., Ford, J., Hoffman, B., Kerr, G., etj. (1999). *Decentralizimi.Shënime përmbledhëse*. Washington,D.C: Instiuti i Bankës Botërore.

Ahmad, Juanid; Blair, Harry; Esmail, Talib; Ford, James; Hoffman, Bert; Kerr, Graham; King, Elizabeth; Lutz, Ernst; Mclean, Keith; Rondinelli, Dennis; Sewell, David; Shah, Anwar; DeTomaso, Giulio; Weist, Dana. (1999). *Decentralizimi. Shënime përmbledhëse*. Washington, D.C: Insituti i Bankës Botërore.

Anthony, L., Alkan, A., Comsa, R., Cuibus, M., Djukic, Z., Elezi, S., etj. (2012). *Indikatorët për decentralizimin fiskal për Europën Jug-Lindore 2006-2011*. Shkup: ZELS.

Balkans, C. d. (2012). Procesi i decentralizimit në Maqedoni. *Normandia e poshtme Maqedonia*.

Davkova, G. S., & Mitkov, V. (2000). *Vetqeverisja Lokale*. Shkup: Magor.

Decentralizimi në Maqedoni. Dolna Normandija/ Makedonija.

Dineva, M., Sasajkovski, S., Coneva, L., Cacanaska, R., Vitanski, D., & Popovski, T. (2011). *Qytetarët në sistemin e vetqeverisjes lokale*. Shkup: Insitui për kërkime sociale dhe të drejta politike.

Dushica, P., Ardita, M., & Viktor, A. (2013). *Doracak-Udhëzues drejt kompetencave për kryetarët e sapozgjedhur të komunave dhe anëtarët e këshillave të komunave*. Shkup: BNJVL.

Gazetaexpress. (2014). Cfarë është Marrëveshja e Ohrit. *Gazetaexpress*.

Gizevius, V. (1998). *Udhëheqës nëpërmjet politikës komunale*. Shkup: Friedrich Ebert.

Gollaj, D. (2013). *PARIMI I AUTONOMISË VENDORE SI NJË NGA PARIMET THEMELORE*. Durrës.

Hristov, G., Naumoski, Z., & Vrteski, J. (2016). *Financat lokale në Republikën e Maqedonisë 2013-2014*. Shkup: AQ Qendra për zhvillim të demokracisë lokale.

Hristov, G., Naumoski, Z., & Vrteski, J. (2016). *Financat lokale në Republikën e Maqedonisë*. Shkup: AQ Qendra për zhvillim të demokracisë lokale.

Kälin, W. (2002). *Decentralization - Why and How*.

KOHAnet. (2014). 13 vjet nga Marrëveshja e Ohrit. *KOHAnet*.

Litvack, J., & Seddon, J. (1998). *Decentralizimi- Shenime përmbledhëse*. Instituti i Bankës Botërore.

Merko, N. (2017). *Decentralizimi fiskal, financimi dhe shërbimet publike në Republikën e Maqedonisë*. Tirane.

Merko, N. (2017). *Decentralizimi fiskal, financimi dhe shërbimet publike në Republikën e Maqedonisë*. Tiranë.

OSCE. (2008). *Hulumtimi rreth Decentralizimit 2008*. Shkup: OSCE.

Perishiq, D., & Angelov, G. (2008). *Unë dhe Komuna ime*. Shkup: ZELS.

Perishiq, D., Mehmeti, A., Arnaudovski, V., Vrteska, N., Serafimova, I., Arsovski, A., etj. (2013). *Doracak-Udhëzues drejt kompetencave për kryetarët e sapozgjedhur të komunave dhe anëtarët e këshillave të komunave*. Shkup: ZELS.

Plaks, L. (2011). *Dhjetë vite nga Marrëveshja Korrnizë e Ohrit*. Tetovë: South East European University.

Rondinelli, D. (1998). *Decentralizimi. Shënime përmbledhëse*. Instituti i Bankës Botërore.

Sela, Y. (2013). *Procesi i Decentralizimit në Republikën e Maqedonisë - çështjet kyçe, tendencat dhe zhvillimet në të ardhmen*. Shkup: Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare.

Sela, Y., Memeti, M., Aliu, A., Kreci, V., Rakipi, A., Sulejmani, R., etj. (2013). *Procesi i decentralizimit në Republikën e Maqedonisë-çështjet kyçe, tendencat dhe zhvillimet në të ardhmen*. Shkup: Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare.

Sergejev, D. (1978). *Sto je lokalna Zajednica*.

Sfidat e aplikimit të tatimit të sheshtë në Republikën e Maqedonisë - Disa aspekte
krahsimore 2010 Tetovë SEEU

SIOFA. (2012). *Raport në lidhje me gjendjen e implementimit të të gjitha politikave që burojnë nga*. Shkup.

ZELS. (2017). *Decentralizimi në Maqedoni*.

ZELS. (2009). *Doracak praktik për punën e komisioneve për marrëdhënie midis bashkësive*. Shkup: ZELS.

ZELS. (2007). *Manual mbi procedurat administrative në procedurën administrative*. Shkup: ZELS.

Fiscal Decentralization. (2007). Gregory K. Ingram and Yu-Hu Hong.

Managing Fiscal Decentralization. (2012). Ehtisham Ahmad and Vito Tanzi.

Fiscal Decentralization in Developing Countries. (2008). Richard M. Bird and François Vaillancourt.

Fiscal Decentralization in Ukraine. Accomplishments and challenges in the Transition. (2011). Jorge Martinez-Vazquez and Wayne R. Thirsk.

Decentralization and Regional Autonomy in Indonesia: Implementation and Challenges. (2009). Coen J G Holtzappel, Martin Ramstedt.

Aghion AR, Howitt P. (1998). Endogenous Growth Theory. MIT Press, Cambridge.

Akai N, Sakata M. (2002). Fiscal Decentralization Contributes to Economic Growth: Evidence from State-Level Cross-Section Data for the United States. Journal of Urban Economics.

Behnisch A, Büttner T, Stegarescu D. (2002). Public Sector Centralization and Productivity Growth: Reviewing the German Experience, ZEW Discussion.

Brennan G, Buchanan JM. (1980). The Power to Tax. Cambridge University Press, Cambridge.

Stegarescu D. (2005). Public Sector Decentralization. Measurement Concepts and Recent International Trends. Fiscal Studies 26, pp 301–333.

Zimmermann H. (1990). Fiscal Federalism and Regional Growth. In: Bennett RJ (ed) Decentralization, Local Governments, and Markets: Towards a Post-Welfare Agenda. Oxford University Press, Oxford, pp 245–264.

Ter-Minassian, T. (1997). Decentralization and macroeconomic management. IMF Working Paper 97/155.

Burime nga Interneti

Perishiq, D., Mehmeti, A., Arnaudovski, V., & Vrteska, N. (2013). *Doracak-Udhëzues drejt kompetencave për kryetarët e sapozgjedhur të komunave dhe anëtarët e këshillave të komunave*. Shkup: http://www.zels.org.mk/Upload/Content/Documents/Izdanijska/Publikacii/Priracnik_zels_2013_ALB.pdf.

Zejnullai, Z. (2015). Decentralizimi. *PORTALB*: <https://portalb.mk/165417-d-e-c-e-n-t-r-a-l-i-z-i-m-i/>

<http://www.siofa.gov.mk/>. (a.d.). Gjetur në Sekretariati për implementimin e marrëveshjes së Ohrit

http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf

Kadriu, I. (2010, prill 2). *Ngec decentralizimi në Maqedoni*. Gjetur në Radio Evropa e Lirë

<https://www.evropaelire.org/a/2000834.html>

<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20per%20zhvillimin%20e%20barabarte%20rajonal.pdf>.

<http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20per%20zhvillimin%20e%20barabarte%20rajonal.pdf>

<http://bn-mk.org/sq/content/decentralizimi-n%C3%AB-maqedoni.html>.

<http://www.struga.gov.mk/wp-content/uploads/2018/04/Ligji-per-zhvillimin-e-barabarte-rajonal.pdf>